RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

Mbi Auditim financiar dhe të përputhshmërisë në subjektin "Bashkia Finiq".

Tiranë, Dhjetor 2021

🕮 PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
I	**PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE**	**4 - 12**
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit……	**4**
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeve……	**4 – 11**
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni I Auditimit…….	**11 – 12**
II	**HYRJA**	**12 – 17**
	a. Objektivat e auditimit..... *b. Qëllimi i auditimit.....* *c. Identifikim i cështjes.....* *d. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....* *e. Përgjegjësitë e Audituesve.....* *f. Kriteret e vlerësimit .....* *g. Standardet e auditimit.....* *h. Metodat e auditimi .....* *i. Dokumenti i auditimit.....*	
III.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.**	**17 -**
1.	**Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.**	**17 – 18**
2.	**Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të audimit.**	**18 -**
2.1.	*Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", ligjet vjetore "Për buxhetin e shtetit" , si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.*	*18 – 27*
2.2.	*Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2019-2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe udhëzimi MFE nr.08, datë 9.3.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme".*	*27 – 35*
2.3	*Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Manualeve përkatëse të punimeve, udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik etj.*	*35 – 67*
IV.	**GJETJE DHE REKOMANDIME.**	**37 - 76**
V.	**ANEKSE.**	**76 - 98**

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
Vendim i KM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
Vendim i KB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHA	Shoqëri Anonimë.
Bashkim i OE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operatori Ekonomik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

Kontrolli i Lartë i *Shtetit (këtu e vijim KLSH),* në periudhën nga data 01.11.2021 deri në 10.12.2021, realizoi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të veprimtarisë ekonomike dhe financiare të subjektit Bashkisë Finiq, të periudhës nga data 01.01.2020 deri më 30.6.2021, duke u përqëndruar kryesisht në organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese, planifikimin, hartimin dhe realizimin e buxhetit; realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat e tarifat vendore; auditimin me zgjedhje i transaksioneve financiare, hartimin e pasqyrave financiare viti 2020, si dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, etj.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti (me zgjedhje), për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.
Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit financiar dhe i përputhshmërisë në KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kritereve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase, si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.
Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, mungesë së të ardhurave dhe të përdorimit jo me efektivitet të fondeve publike (3-E), i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të Audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të Bashkisë Finiq për periudhën nga data 01.01.2020 deri më datë 30.6.2021, grupi i auditimit konkludoi në një opinion të **kundërt**i për aspektin financiar (pasqyrat financiare viti 2020), ndërsa për aspektin e përputhshmërisë së procedurave të prokurimit ka dalë me opinion të **kualifikuar**.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 5 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
1.	Nga auditimi i të dhënave të marrë nga Drejtoria e Financës Bashkia Finiq për vitin 2020, u konstatua se shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 647,838 mijë lekë dhe	I lartë	18-27	Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin e të Ardhurave, të marrin masa për hartimin e një buxheti real,

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	janë realizuar në vlerën 642,886 mijë lekë ose në masën 99 %, *kjo sipas artikujve*: paga në masën 97%, sigurime në masën 97 %, shpenzime operative në masën 98 %, dhe investime në masën 100 %. Sipas burimeve të financimit dhe alokimit të fondeve për vitin 2020, u konstatua se nga transferta e pakushtëzuar (grandi) treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 133,563 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 133,563 mijë lekë ose në masën 100 %. Nga këto*:* - Investime nga vlera 39,394 mijë lekë e planifikuar, janë realizuar në vlerën 39,394 mijë lekë ose në masën 100 %. - Nga të ardhurat e trashëguara dhe të ardhurat e vitit, treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 64,478 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 64,478 mijë lekë ose në masën 100 %. - Nga transferta e pakushtëzuar me fonde të deleguara, janë planifikuar për vlerën 449,797 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 444,845 mijë lekë ose në masën 99 %. Nga analiza e të dhënave për pjesën e të ardhurave, u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit të planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit. Kështu të ardhurat veta të planifikuara për vlerën 93,730 mijë lekë janë realizuar në vlerën 64,478 mijë lekë me diferencë për vlerën 29,252 mijë lekë. Pra planifikimi i shpenzimeve buxhetore nuk është real dhe i mbështetur në burime të sakta financimi për të ardhurat e veta, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" nenet 42,43,47,50,52 dhe 65; Udhëzimit të MF nr. 2 datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit" i ndryshuar, pikat 253, 354; Udhëzimit të MF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 40 dhe 48, si dhe vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak			mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse
2.	Nga auditimi u konstatua se në buxhetin e miratuar për vitin 2020, nuk janë programuar si zë më vete, likuidimi i të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguara nga viti paraardhës, ku sipas pasqyrave financiare për vitin 2019 janë në shumën 134,462,229 lekë ose 41 % e	I lartë	18-27	Kryetari i Bashkisë Finiq, të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material analizë për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, për vlerën **42,120,146 lekë** dhe të hartojë një grafik likuidimesh, duke zbatuar radhën

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	buxhetit fillestarë. Në fund të vitit 2020, sipas pasqyrave financiare ato paraqiten në shumën 65,375,633 lekë, *nga të cilat:* deri me datë 30.9.2021 janë likuiduar gjithsej vlera 22,255,487 lekë, duke mbetur për likuidim vlera **42,120,146 lekë, kjo si rezultat i mos realizimi i të ardhurave**. Nga auditimi i pagesave për shpenzime operative/ investime/ etj, të realizuara nga ana e Bashkisë Finiq, për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020, u konstatua se 122 fatura në vlerën 18,954,299 lekë nuk janë likuiduar brenda afatit **30 ditor** nga momenti i paraqitjes se tyre. Gjithashtu u evidentuan dhe 17 raste ku faturat e paraqitura për likuidim nuk janë likuiduar në vlerën e plotë të tyre, ku nga vlera e faturave prej 43,902 mijë lekë është likuiduar vlera prej 15,967 mijë lekë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, Udhëzimin e MF nr. 2 datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit" (me ndryshime), pikat 101, 253, 354; Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 40, 48			e pagesave
	Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020, nuk është kryer inventari fizik i Aktiveve Afatgjata. Nga të dhënat e pasqyrave financiare (aktivi), u konstatua se në kontabilitet llogaritë 210 "*Toka, troje, terrene*", 211 "*Pyje Plantacione*", 212 "*Ndërtesa e Konstruksione*", 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*", 214 "*Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune*" 215 "*Mjete transporti*", nuk janë të analizuara, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave, si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj. Në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe	I lartë	27-35	Kryetari i Bashkisë Finiq, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për inventarizimin e aktiveve të veta si: llogaritë 210 "*Toka, troje, terrene*", 211 "*Pyje Plantacione*", 212 "*Ndërtesa e Konstruksione*", 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*", 215 "*Mjete transporti*", duke bërë dhe verifikimin në terren të këtyre Aseteve. Për diferencat eventuale të konstatuara dhe për vlerat jashtë përdorimit nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemimin e llogarive kontabël

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet. Bazuar në sa më sipër nuk japin arsye që të kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive, për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" (me ndryshime) pikat 26, 28, 30, Kreu IV, pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu II, "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 5			
3.	Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020 gjendja e llogarisë 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*" në aktiv nuk rakordon me gjendjen e llogarisë kundërparti 467 "*Kreditorë të ndryshëm*" dhe llogarisë 401-408 "*Furnitor e llogari të lidhura me to*" në pasiv të bilancit e cila paraqitet për vlerën 65,375,633 lekë, për faktin se diferenca për vlerën 15,270,092 lekë është pasqyruar në aktiv në llogarinë 4342 "*Operacione me shtetin (të drejta)*", veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 5	I lartë	27-35	Drejtoria e Financës në Bashkinë Finiq, të marrë masa për sistemimet e llogarive me vlerat e tyre reale, për llogarinë 4342 "*Operacione me shtetin (Të drejta)*", për vlerën 10,083,148 lekë dhe llogarisë 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*", për vlerën 65,375,633 lekë
4.	Nga auditimi u konstatua se llogaria 231 "*Shpenzime në proces për rritjen e AQT"* në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 0 (zero) lekë, por duhet pasqyruar për vlerën 215,996,403 lekë, pasi në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se për vitin 2020 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit të cilat janë pasqyruar në llogaritë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" për objektin " *Ujësjellësi rajonal Bashkisë Finiq linja e jashtme burimet e Merkos*" në vlerën 211,624,933 lekë dhe	I lartë	27-35	Drejtoria e Financës, Bashkia Finiq, të marrë masa për sistemimet e llogarive me vlerat e tyre reale duke kredituar llogarinë 231"*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*", në vlerën 215,624,933 lekë dhe debituar llogarinë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" në vlerën 211,624,933 lekë si dhe llogarinë 214 "*Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune*", për vlerën 4,371,470 lekë

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	llogarinë 212 "*Ndërtime konstruksione*" për objektin "*Rikonstruksion i vatrës së kulturës Dhrovjan*" në vlerën 4,371,470 lekë, pra vlera e llogarie 231 "*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*", veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Aneksi 1, Klasa 23			
5.	Në fund të vitit 2020, llogaria 466 "*Kreditorë për mjetet në ruajtje*" në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 30,809,350 lekë, e rakorduar me Degën e Thesarit. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se kjo vlerë përfaqëson fondet e ngurtësuara, ku vlera 20,477,231 lekë i përket ngurtësimeve të viteve 2019 e më parë, të cilave u ka kaluar afati i garancisë. Bashkia Finiq nga ana e saj nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për ç'bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për interes publik, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" (me ndryshime), Kap. II, pika 10	I lartë	27-35	Drejtoria e Financës në Bashkinë Finiq, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2019 e më parë (vlera 20,477,231 lekë), për të cilat ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Delvinë, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik
6.	Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Finiq ka transferuar në vitin 2020 asetet për shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime" sha në shumën 143,696,762 lekë që i përkasin llogarisë 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*". Nga vlera 334,796,075 lekë e rivlerësuar nga ekspert vlerësues të pasurisë së paluajtshme të licensuar me Vendim Gjykate nr. 23-2017-631(318), datë 04.04.2017, transferime të cilat nuk janë bërë me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe nuk janë bërë veprimet kontabël, për rrjedhojë pasqyrat financiare të vitit 2020, nuk pasqyrojnë saktë gjendjen e Aseteve të Bashkisë Finiq si aksionere në shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime" sh.a, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pikat 35/a, b, 42, 44 dhe Udhëzimin e MF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e	I lartë	27-35	Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për saktësimin e Aseteve që i përkasin shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime" sh.a. Të bëhet transferimi i tyre me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët dhe të kryhen veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	qeverisjes se përgjithshme" Kap. II, neni 17			
7.	Nga të dhënat e Drejtorisë së Financës, u konstatua se për periudhën 01.01.2020 deri më 30.6.2021 nga vlera e kontratave të lidhura prej 1,195,394 mijë lekë janë planifikuar dhe miratuar në buxhet për likuidim vlera 392,519 mijë lekë. Janë likuiduar deri me datë 30.6.2021 vlera prej 291,568 mijë lekë dhe mbetur për likuidim vlera **100,951 mijë lekë.** Nga sa mësipërm, Bashkia Finiq planifikon procedura në mungesë të realizmit të të ardhurave, pasi megjithëse ka kontrata të pa likuiduara nga periudha në periudhë, vijon me planifikimin e procedurave të reja, pa një studim të mirëfilltë të fondeve në përdorim, **veprime të cilat në fund çojnë në rritjen e borxhit për faturat e palikuiduara.** Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91; Ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 40, 48: Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"	I lartë	37-67	Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike gjatë hartimit të buxheteve, planifikimi i procedurave të prokurimit të jetë në raport me nivelin e të ardhurave të realizuara për vitin dhe grandeve të planifikuara nga buxheti qendror dhe jo me të ardhurat e parashikuara për vitin ushtrimorë
8.	Referuar të dhënave të regjistrit të procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2020 deri më 30.6.2021, janë realizuar gjithsej **23** procedura me fond limit 1,317,897 mijë lekë dhe vlerë kontrate 1,246,303 mijë lekë, me ulje për vlerën 71,594 mijë lekë ose 5.4%. Grupi i KLSH-së, referuar vlerësimit të të dhënave të materialitetit nga 23 procedura, me fond limit 1,317,897 mijë lekë, ka vlerësuar për auditim **8** procedura me fond limit 1,285,942 mijë lekë ose 97.5% të fondit të prokuruar. Nga auditimi i **8** procedurave me fond limit 1,285,942 mijë lekë, janë konstatuara në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej **7** procedura me vlerë të fondit limit 266,329 mijë lekë ose 20.7% *(të dhëna të paraqitura në Aneks 2.4 të Raportit Përfundimtar të Auditmit)*, shkelje të cilat kanë konsistuar në këto mangësi: **I-** Në **6 (gjashtë)** procedura, Njësia e Prokurimit Bashkia Finiq, ka aplikuar në dokumentet standarde të tenderit (DST), kritere jo me llojin e procedurave të zhvilluara dhe jo në përputhje me kuadrin ligjor të LPP, *konkretisht:* - Procedura e prokurimit me objekt: *"Ujësjellësi Rajonale i Finiqit (linja e*	I lartë	37-67	Kryetari i Bashkisë Finiq në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikat e zhvillimit të procedurave me një OE. Të bëhet argumentimi teknik për secilin kriter, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve dhe dokumentacioni i argumentimit të kritereve të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	jashtme), Burimet e Merkos, ndërtim montime makineri e Paisje", me Urdhër Prokurimi (UP) nr. 5, datë 05.03.2020, lloji i procedurës ´"*Hapur*" dhe fond limit 469,080 mijë lekë, . - Procedura e prokurimit me objekt: *"Rikonstruksion dhe zgjerim i linjës ekzistues të ujësjellësit Krongj - Finiq, linja të reja të jashtme të fshatrave Vrion, Karahaxh, Çlirim, Bregas si dhe linja e brendshme e fshatit Çlirim, Bashkia Finiq",* me UP nr. 23, datë 7.12.2021, lloji i procedurës ´"*Hapur*" dhe fond limit 250,906 mijë lekë . - Procedura e prokurimit me objekt: *"Ndërtimi i ujësjellësit rajonal të Finiq nga burimet e Leshnicës",* me UP nr. 22, datë 26.11.2020, lloji procedurës ´"*Hapur*" dhe fond limit 393,824 mijë lekë . - Procedura e prokurimit me objekt: *"Blerje materiale ndërtimi",* me UP nr. 5, datë 23.3.2021 dhe fond limit 9,491 mijë lekë, lloji procedurës ´"*Hapur*". - Procedura e prokurimit me objekt: *"Rikonstruksion i rrugës Dermish - Jerme",* me UP nr. 4, datë 2.3.2021 dhe fond limit 79,916 mijë lekë, lloji procedurës ´"*Hapur*". Veprime dhe mosveprime që bien në ndesh me Vendimin e KM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (me ndryshime), neni 26 "*Kontratat për punë publike*", pika 7 dhe neni 61, "*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*", pika 2, paragrafi 2			
9.	Në procedurën me objekt: *"Restaurim i Urës - Kanali Filipeu me strukturë metalike B/A",* me fond limit 15,423 mijë lekë, procedurë në të cilën ka marrë pjesë 1 (një) operatorë ekonomik, respektivisht Bashkimi i OE J.... shpk & SH..... shpk, me ofertë 15,313,774 lekë, operatori ekonomik i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve të DST të miratuara nga AK, procedura e cila duhej anuluar nga KVO-ja dhe zhvilluar procedurë tjetër me kushte më të favorshme për të siguruar përdorimin me efektivitet, efiçencë dhe ekonomicitet (3-E) të fondeve të prokuruar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", (me ndryshime), neni 2, *"Parimet e përzgjedhjes",* neni 24, *"Anulimi i një procedure",* neni 46, *"Kualifikimi i ofertuesve"*, pika 1, neni 47, "*S`kualifikimi i*	I lartë	38-67	Kryetari i Bashkisë Finiq, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kritereve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik pa ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet (3-E)

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	ofertuesve", neni 53, *"Shqyrtimi i ofertave",* neni 55, *"Kriteret e përcaktimit të ofertës",* neni 58, *"Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës"*, Vendimi i KM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", (me ndryshime), neni 26, "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 5, neni 66, "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", neni 67, *"Klasifikimi i ofertave"*, neni 69, *"Njoftimi i fituesit"*, neni 70 *"Lidhja e kontratës"*, neni 78 **"***Ankesat në autoritetin kontraktor*, si dhe rekomandimeve të APP			
10	Nga auditimi i dokumentacionit për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Bashkia Finiq, konstatohet se në fund të vitit 2020 janë gjithsej debitorë **224** subjekte fizik/juridik në vlerën **15,332,000 lekë** dhe **5306** abonent familjarë në vlerë **157,346,000 lekë.** Nuk u konstatua asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimit të debitorëve, deri në **nxjerrjen e urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal** të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve, veprime në kundërshtim me Kreun XI "*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" (me ndryshime)	I lartë	18-27	Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike në Bashkinë Finiq, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2020 në vlerën **172,678,000 lekë**, *si më poshtë vijon***:** ***a-T'u dërgohen bankave*** të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare,. ***b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit***, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),. ***c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar***, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar. ***d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet***, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave <u>të bëhet kallëzim penal</u>

I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

- Nga auditimi i pasqyrave financiare (bilance) të vitit 2020, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një "**Opinion të kundërt"**, pasi ka llogari të Aktiveve të krijuara në viteve paraardhëse për të cilat, mungon dokumentacioni i nevojshme kontabël e ligjor mbi krijimin dhe përmbajtjen ekonomike të

tyre, ndërkohë që konstatohet se nga bashkia nuk është bërë inventarizim fizik i Aktiveve të Qëndrueshme për të saktësuar vlerat në pasqyrë.

- Në zbatimin e buxhetit, të ardhurat për vitin 2020 dhe procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2020 – 30.6.2020, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkia Finiq, bazuar në analizën e riskut, janë konstatuar anomali në vendosjen e kritereve dhe shpalljen fitues të OE me kritere jo të plotësuara, që janë baza për dhënien e një **"Opinion të kualifikuar",** duke çuar në përdorimin pa efektivitet, efiçencës dhe ekonomicitet (3-E), të fondeve të prokuruar.

Opinioni auditimit

I. Opinioni i pasqyrave financiare vitin 2020:

Objektivi i Audituesve në auditimin financiar është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nëse këto pasqyra janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale dhe në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.
Ne kemi audituar pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2020, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese.
Auditimi ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh të dokumenteve që mbështesin shumat e llogarive të pasqyrave financiare. Është bërë vlerësimi i parimeve kontabël të aplikuara, vlerësimeve të bëra nga drejtuesit si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.
Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1700[1], dhe ISSAI 1200[2], pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet, pozitën financiare të Bashkisë Finiq më datat 31 dhjetor 2020, referuar ligjit "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe Akteve të tjera nënligjore mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore, të cilat justifikojnë dhënien e **Opinionit të kundërt**[3] për pasqyrat financiare të vitit 2020**,** e shprehur kjo në bazën për opinion.

Baza për opinionin:
Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:
-Ka llogari të aktiveve të krijuara gjatë viteve paraardhëse për të cilat, mungon dokumentacioni i nevojshme kontabël e ligjor mbi krijimin dhe përmbajtjen ekonomike të tyre, ndërkohë që konstatohet se nga Bashkia nuk është bërë inventarizim fizik i Aktiveve të Qëndrueshme për të saktësuar vlerat në pasqyrë.
-Llogaria 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*", nuk pasqyron saktë gjendjen e saj, pasi nga vlera 334,796,075 lekë e vlerësuar me ekspertë të licencuar për të kaluar në ndërmarrjen e "Ujësjellës Kanalizime" sha, ka kaluar vlera 143,696,762 lekë.

[1]*Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.*
[2]*Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi*
[3]**Opinioni i kundërt.** *Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku,* ***janë materiale, të përhapura****, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë* ***dëshmi të mjaftueshme*** *dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale të përhapura.*

-Në llogarinë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*", vlera prej 20,477,231 lekë, janë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2019, të cilave u ka kaluar afati i garancisë, por që nuk është ndërmarrë asnjë veprim për sistemimin e kësaj llogarie.
-Llogaria 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*", në aktiv nuk rakordon me gjendjen e llogarisë kundërparti 467 "*Kreditorë të ndryshëm*" dhe 401-408 "*Furnitorë e llogari të lidhura me to*", pasi në pasiv të bilancit paraqitet për vlerën 65,375,633 lekë, për faktin se diferenca për vlerën 15,270,092 lekë është pasqyruar në aktiv në llogarinë 4342 "*Operacione me shtetin (të drejta*)".
-Llogaria. 231 "*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*", në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 0 (zero) lekë, kur në fakt nga testimi kjo llogari duhej të paraqitej në vlerën 215,996,403 lekë, pasi ka kontrata për investime të papërfunduara.

II. Opinion i auditimit mbi përputhshmërinë:

Nga auditimi mbi përputhshmërinë e procedurave të prokurimit (periudha 01.01.2020 – 30.6.2021), sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti **"Bashkia Finiq"**, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord *(kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), u evidentuan në përgjithësi zbatimi tyre, por në disa raste u konstatuan devijimeve nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret/vlerësim), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur justifikojnë dhënien e një ***"Opinionin e kualifikuar***[4]", e shprehur kjo në bazën për opinion.

Baza për dhënie opinioni:

Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit dhe materialiteti (2%), përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara.
Ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e një ***opinioni të kualifikuar*.**
- Mbi përcaktimin e kritereve dhe specifikimeve teknike për kualifikim, ku janë evidentuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës (*në 6 raste*) dhe në shpalljen fitues (*në 2 raste*) të operatorët ekonomik jo në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve për kualifikim, proceduara të cilat duhej anuloheshin dhe zhvilluar procedura të tjera me kushte me të favorshme për të garantuar një përdorim me efektivitet, ekonomicitet dhe efiçencë (3-E) të fondeve të prokuruar, trajtuar në pikën III/2.3 faqe 38-72 të Raport Auditimit.
-Në lidhje me të ardhurat, konstatohet se nuk është ndjekur e plotë procedura ligjore për arkëtimin e tyre.
- Nuk është planifikuar si zë më vetë detyrimet për faturat e palikujduara të vitit paraardhës.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Finiq*:*

Strukturat drejtuese të Bashkisë Finiq, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (*kriteret e vlerësimit*). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullative në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Finiq janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për

[4] *Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar:*
1. Kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose
2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura

përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:
Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi material apo anomalie që mund të ekzistojë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të projektit dhe programit të auditimit nr. 1116/1, datë 01.11.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 01.11.2021 deri në datë 10.12.2021, në subjektin Bashkia Finiq, për periudhën nga 01.01.2020 deri në 30.6.2021, u krye auditimi "*Mbi Auditimin financiar dhe përputhshmërie së procedurave të prokurimit*" nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. K. Gj, *Përgjegjës Grupi*
2. P. Gj, *auditues*

a- Objektivi i auditimit: Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve, për të arritur objektivin e këtij auditimit që është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2020, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.
Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim.

b- Qëllimi i auditimit: Qëllimi i auditimit u realizua pas analizës së implementimit të kërkesave të MFK, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt, me synim dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallra/shërbime e investimeve.
Ky projekt auditimi do të shtrihet për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2020 deri në datë 30.6.2021, si dhe do të ketë si fushëveprimi, buxhetin, auditimin e pasqyrave dhe transaksioneve financiare dhe procedurat e prokurimit me fonde publike.

c- Identifikimi i çështjes: Referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit dhe auditimit në terren, u identifikuan fushat me risk më të lartë. Gjithashtu, sigurojmë që vlerësimi fillestar i riskut në fazën e planifikimit si dhe ai i aplikuar gjatë fazës së auditimit në terren, vijon të mbetet i vlefshëm, si dhe nuk ka rishikim të tij.

Sa më sipër, fushat me risk të lartë u përcaktuan drejtimet e auditimit të miratuara sipas Programit të Auditimit, nr. 1116/1, datë 01.11.2021, "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë", si më poshtë:

a- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", ligjet vjetore "Për buxhetin e shtetit" të vitit 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.
b- Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare të vitit 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

c- Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (me ndryshime) dhe Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24.04.2017 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël".

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për te dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Finiq.

d- <u>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese</u>: Strukturat drejtuese të Bashkisë Finiq, janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. të Bashkisë Finiq, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", konkretisht neni 34, pika 6, neni 65, pika 1 dhe neni 91, pika 1.3.

e- <u>Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH</u>-së: Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi aktivitetin e Bashkisë Finiq, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe efiçent të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.
Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.
Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.
Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

f- <u>Kriteret e vlerësimit</u>: Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit sa më poshtë:

- ***<u>Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:</u>***

Ligji nr. 88/18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2020" dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" ndryshuar me ligjin nr. 24/2015, datë 19.903.2015; VKM 783 datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël"; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm"; Udhëzimi i MF nr. 9, datë 20.03.2018 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit", etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" (me ndryshime); Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.02.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 "Për përgatitjen e buxhetit vendor"; Udhëzimin plotësues të MF nr. 02, datë 10.01.2018 "Për buxhetin e vitit 2018", pikat 82-91 "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore"; Udhëzimin e MF nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore"; Udhëzimi plotësues i MF nr. 01, datë 17.01.2019 "Për buxhetin e vitit 2019", pikat 106-110, "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", dhe pikat 116-117- Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore''.

- ***Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit Pasqyrave Financiare:***

Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" (me ndryshime); VKM nr. 248, date 10.4.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre" (me ndryshime); VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël"; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial"; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 9.3.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme".

- ***Në fushën e prokurimeve publike:***

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (me ndryshime); Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" (me ndryshime) dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik; Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla" (me ndryshime); Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 "Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë";

- ***Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:***

Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" (me ndryshime); Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 "Për Sistemin e Taksave Lokale" (me ndryshime); Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për Taksat Kombëtare" (me ndryshime); Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" (me ndryshime).

g- Standardet e auditimit: ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 "*Udhëzues të Auditimit Financiar*"; ISSAI 2300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*"; INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*" si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*"; ISSAI 400 "*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*", i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 "*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*"; si dhe ISSAI 4200 "*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*"; INTOSAI "*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*"; etj. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të

Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.; Kodit Etik dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

gj- <u>Metodat e auditimit</u>: Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.
Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve.
Po kështu nga ana jonë u përshkrua legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, caktimi i përgjegjësisë dhe autoritetit, etj.

l- <u>Dokumentimi i auditimit</u>: Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit Përputhshmërisë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.06.2020, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "*Dokumentimi i Auditimit*".
Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.
Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.
Teknikat e kontrollit të përdorura gjatë auditimit janë; *kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi*.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

III/1. Informacioni i Përgjithshëm:

Auditimi në Bashkinë Finiq u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës por jo të përhapura si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me shpenzime jo sipas 3-E në fushën e prokurimeve.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë

auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e konkluzioneve. Dokumentacioni i marrë për auditimin është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.
Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditmit mbi problemet e konstatuara ka mbajtur akt-konstatime, kopjet e të cilave u dorëzuan në zyrën e protokollit Bashkia Finiq deri me datë 10.12.2021.

Në lidhje me problematikat e konstatuara nga subjekti me shkresën përcjellëse nr. 3571, datë 16.12.2021, janë paraqitur kundërshtitë, të cilat janë marrë në konsideratë ato raste të cilat kishin mbështetje ligjore dhe me dokumentacion mbështetës, ndërsa për rastet e tjera të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga grupi i KLSH, problemet ishin trajtuar në Projekt Raport Auditimi, i cili ju paraqit subjektit për vërejtje me shkresën nr. 1116/2, datë 20.12.2021.

Nëpërmjet shkresës së Bashkisë Finiq nr. 3660, datë 28.12.2021 *(prot KLSH nr. 1116/3, datë 29.12.2021),* janë paraqitur kundërshtitë e Projekt Raport Auditimi, të cilat pasi janë analizuar me kujdes, profesionalizim dhe paanshmëri, janë marrë në konsideratë ato raste të cilat kishin mbështetje ligjore dhe me dokumentacion mbështetës. Ndërsa për mangësitë e tjera të cilat nuk kishin argumentin e duhur ligjore gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditmit, i cili përcillet subjekti për marrjen e masave për përmisimin e gjendjes në të ardhmen.

Bashkia Finiq është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes Vendore", Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregullorja dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Finiq.

1.Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:
Bashkia Finiq bën pjesë në Qarkun e Vlorës.
Të dhëna të përgjithshme:
Zona Gjeografike: Bashkia e re e Finiq kufizohet në veri me bashkinë Delvinë, në jug me bashkinë Konispol, në lindje me bashkinë Dropull dhe në perëndim me bashkinë Sarandë. Kryeqendra e Bashkisë është Finiq.

Popullsia: Sipas Regjistrit Civil kjo bashki numëron 39,055 banorë në një sipërfaqe prej 441.20 km^2. Në bazë të regjistrit civil densiteti është 88.51 banorë/$km^{2.}$
Njësitë administrative përbërëse janë: Finiq, Aliko, Mesopotam, Dhiver dhe Livadhja. Të gjitha njësitë administrative janë pjesë e rrethit Sarandë, Qarku Vlorë.

Profili i bashkisë

Bashkia Finiq është një bashki që shtrihet në zonën bujqësore të fushës së Vurgut dhe në zonën malore të rrëzomës së Vurgut. Banorët e zonës i përkasin minoritetit grek dhe kjo zonë ka përjetuar hemorragji demografike si pasojë e largimit të popullsisë drejt kërkimit të një jete më të mirë në Greqi.
Zona bujqësore është pjellore dhe aktiviteti bujqësor është rigjallëruar gjatë viteve të fundit.

Infrastruktura është përmirësuar gjatë dy dekadave të fundit falë investimeve të shumta ndërkufitare por emigrimi ka larguar nga zona pjesën më të madhe të popullsisë, veçanërisht të rinjtë, duke lënë pas njerëz të moshuar.

III/2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të audimit

III/2.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar me ligjin nr.88/2019, datë 18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2020" dhe aktet normative që e ndryshojnë këto ligje, me ndryshimet.

1.1 Mbi programimin e PBA 2020-2022 dhe programimi i buxhetit vjetor 2020.

Projekt buxheti për vitin 2020 është hartuar në përputhje me kriteret dhe kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 8.7.2010, "*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" të ndryshuar, ligji nr. 68-2017, "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*", ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*"," ka paraqitur në Këshillin e Bashkisë për miratim PBA 2020-2022 dhe buxhetin e vitit 2020, i cili është miratuar me Vendim të KB nr. 30, datë 28.12.2019, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë nr. 37/1, datë 20.01.2020.

Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 7 - programe buxhetore. Gjatë hartimit të PBA për vitet 2020-2022 janë përcaktuar "Përshkrimi" i çdo program, "Politika e programit", "Qëllimi i Politikës së programit", "Objektivat e politikës së programit". Gjithashtu çdo program ka të përcaktuar produktet e programeve buxhetore, në të dy fazat e përgatitjes së tij, shpërndarja e fondeve sipas programeve paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për vitin 2020 në PBA, krahasuar me shpenzimet sipas buxhetit, paraqitet si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Plan vitit 2020, në 000/lekë	Sipas PBA 2020, në 000/lekë	Ndryshimi, në 000/lekë
1	Shpenzime për pagat (600+601)	128,403	122,932	5,471
2	Shpenzime (602.604.609)	71,906	60,465	11,441
3	Investime Bashkia	127,783	20,986	106,797
	Total	**328,092**	**204,383**	**123,709**

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për *"fondin e pagave" dhe "sigurimeve shoqërore" (600 , 601),* llogaritja e tyre është bazuar në nivelin aktual të punonjësve për secilin program buxhetor të pagave sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për *Shpenzime të tjera korente (602-609)* llogaritja për programimin e tyre, është bërë bazuar në kërkesat e institucioneve të vartësisë së këtij institucioni, limiteve të miratuara nga Këshilli Bashkiak, limiteve të shpenzimeve të periudhave paraardhëse dhe realizimi i pritshëm.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për *"investime" (230-231),* është bërë duke mbajtur në konsideratë tendencën e realizimit të të ardhurave të veta, grandit dhe fondet që vijnë nga buxheti i shtetit dhe ato të FZHR-së.

Për vitin 2020, buxheti vjetor është miratuar me Vendim të KB nr. 30, datë 28.12.2019, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, nr. 37/1, datë 20.01.2020

Burimet e financimit të buxhetit të bashkisë për vitin 2020, janë si në pasqyrën që vijon:

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2020	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura të trashëguara nga viti pasardhës	3,730	
2	Transfertës e pakushtëzuar trashëguar viti pasardhës	25	
3	Transferta specifike të Trashëguar	2,488	
4	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	90,000	
	Granti	133,538	
5	Transferta specifike	98,311	
6	Paga (600)		110,836
7	Sigurime shoqërore (601)		17,567
8	Shpenzime operative (602)		68,306
9	Transferta (604) Fondi Rezervë		3,600
10	Inv(230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez		59,317
11	Investime nga FZHR e M. Linjës Det Prapambetur		55,223
	Te tjera (166, 651, 603, 604, 606)Programe BE		13,243
Totali i buxhetit		**328,092**	**328,092**

Të ardhurat e veta dhe grand i pakushtëzuar zënë 69 % ose në vlerën 227,293 mijë lekë ndërsa 31% janë grande specifike ose në vlerën 100,799 mijë lekë.

Në buxhetin e miratuar, nuk janë programuar si zë më vete, likuidimi i të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguara nga viti paraardhës që sipas pasqyrave financiare për vitin 2019, janë në shumën totale **134,462,229 lekë** ose 41 % e buxhetit fillestarë, *nga të cilat*:
Vlera 92,743,378 lekë, llogaria 467- *Kreditorë të ndryshëm,*
Vlera 41,718,851 lekë, llogaria 401-408- *Furnitor e llogari lidhura me to,*
Konstatohet se për vitin 2020 janë parashikuar si zë më vete vetëm detyrimet për vlerën 55,222 mijë lekë ose 41% nga vlera 134,462 mijë lekë, veprime në kundërshtim me kërkesat e nenit 101 të Udhëzimit të MF nr. 2, datë 6.2.2012 "Për procedurat Standard të zbatimit të buxhetit".

1.2 Mbi dokumentacionin mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.
Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit, të cilat janë kryer me Vendime të KB, si më poshtë:
Për vitin 2020, kemi rritje të buxhetit fillestarë për vlerën 213,345 mijë lekë, për investim për "Ujësjellësin burimet e Merkos" dhe 325 mijë lekë pagesë për sig. Shoqërore ujësjellësi.
Për viti 2020, si rezultat i këtyre ndryshimeve buxheti përfundimtar i planifikuar, vlera me të cilat është rakorduar me thesarin në fund të vitit, nga vlera 328,092 mijë lekë në fillim të vitit, në fund të vitit është për vlerën 647,838 mijë lekë.

1.3 Mbi dokumentacionin mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore sipas pasqyrës më poshtë:

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2020, në tërësi.

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi	2020		
		Plan	Fakt	Real.%
1	Paga 600	116,302	113,261	97
2	Sigurime shoqërore 601	19,063	18,480	97
3	ShP. Operat 602	72,620	71,596	98
4	Subvencion 603	325	325	100
5	Ndihmë ekon. 606	104,182	104,075	100
6	Investime	334,344	334,147	100
7	Transferta 604	1,002	1,002	100
	Totali	**647,838**	**642,886**	**99**

Sa më sipër për vitin 2020, shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 647,838 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 642,886 mijë lekë ose në masën 99 %, sipas artikujve: *paga në masën 97%, sigurime në masën 97 %, shpenzime operative në masën 98 %, dhe investime në masën 100 %.*
Sipas burimeve të financimit për vitin 2020, **nga transferta e pakushtëzuar** (grandi) treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 133,563 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 133,563 mijë lekë ose në masën 100 %.
Nga këto investime nga vlera 39,394 mijë lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 39,394 mijë lekë ose në masën 100 %.
Nga të ardhurat e trashëguara dhe të ardhurat e vitit, treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 64,478 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 64,478 mijë lekë ose në masën 100 %.
Nga transferta e pakushtëzuar dhe fondet e deleguara treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 449,797 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 444,845 mijë lekë ose në masën 99 %.
Sa më sipër në planifikimin e shpenzimeve nuk janë marrë në konsideratë faturat e palikuiduara të vitit paraardhës që për vitin 2019 janë në vlerën **134,462,229 lekë** ose 41% e buxhetit fillestarë.

Nga auditimi i shpenzimeve të cilat janë planifikuar të mbulohen nga të ardhurat e veta**,** u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit të planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre.
Kështu nga të ardhurat veta të planifikuara dhe të realizuara, këto të fundit të alokuara në buxhetin e vitit 2020 ka diferenca të dukshme, duke bërë që buxheti për vitin 2020 të ketë mosrealizime, konkretisht pasqyra:

Vitet	Programimi dhe realizimi i të Ardhurave		Diferenca	Planifikimi dhe përdorimi i të ardhurave në Buxhet		Diferenca
	Plani	Fakti		Plani fillim Buxhetit	Fakti në thesar sipas realizimit dhe i trashëguar.	
Viti 2020	90,000	64,478	**25,522**	64,478	64,478	**0-**

Nga të dhënat e tabelës, konstatohet se shpenzimet buxhetore të cilat janë planifikuar të mbulohen nga të ardhurat nuk janë realizuar për vlerën 25,522 mijë lekë, pasi të ardhurat nga taksat e tarifat vendore nga vlera 90,000 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 64,478 mijë lekë ose 71 %, me një mosrealizim në vlerën **25,522 mijë lekë**.

a. Mbi dokumentacionin mbi nivelin e faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Nga të dhënat e pasqyrave financiare 2020 (bilanci), konstatohet se totali i faturave të palikuiduara në fund të vitit 2020 në janë për **vlerën 65,375,633 lekë** nga këto:
Llogaritë 401-408 "*Furnitorë e llogari të lidhura me to*" për vlerën 5,013,123 lekë e analizuar për 15 subjekte dhe llogaria 467 "*Kreditorë të ndryshëm*" për vlerën 60,362,510 lekë, e analizuar për 29 subjekte .

Deri me datë 30.09.2021 nga totali i faturave të palikuiduara në fund të viti 2020 nga vlera **65,375,633** lekë, është likuiduar gjithsej vlera 22,255,487 lekë, duke paraqitur një gjendje të faturave të palikuiduara me datë 30.09.2021 **për vlerën 42,120,146 lekë,** *nga këto:*
llog (*467*) "*Kreditorë të ndryshëm*", në **vlerën 42,120,146 lekë,**

Nga auditimi i pagesave për shpenzime operative/ investime/ etj, të realizuara nga ana e Bashkisë Finiq, për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020, u konstatua se nuk janë likuiduar gjithsej 122 fatura në vlerën 18,954,299 lekë brenda afatit **30 ditorë** nga momenti i paraqitjes se tyre.
Ndërsa në lidhje me mos likuidimin e plotë të vlerës së faturës për shpenzime operative/ investime/ etj, të realizuara nga ana e Bashkisë Finiq, për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020, u konstatua se nuk janë likuiduar gjithsej 17 raste, ku nga vlera e faturave të paraqitur për likuidim prej 43,902 mijë lekë është likuiduar vlera prej 15,967 mijë lekë, duke mbetur për likuidim vlera 27,934 mijë lekë, sipas pasqyrës si më poshtë:

PERIUDHA	Nr/datë fature	Shuma	Nr/USH	Vlera	Diferenca
Janar 2020	16/11.07.2019	1,497,360	28/20.01.2020	197,360	1,300,000
Janar 2020	21/05/2019	14,622,272	32/20.01.2020	2,123,803	12,498,469
Shkurt 2020	7/25.06.2020	4,566,840	88/25.02.2020	1,566,840	3,000,000
Mars 2020	41/11.06.2019	519,600	135/30.03.2020	600,000	-80,400
	42/11.06.2019	1,022,964		0	1,022,964
Mars 2020	328/18.06.2019	1,424,640	87/02.03.2020	1,998,720	-574,080
Mars 2020	278/15.05.219	162,000		0	162,000
	154/22.05.2019	412,080		0	412,080
Mars 2020	41/11.06.2019	519,600	309/22.07.2020	1,614,164	-1,094,564
Gusht 2020	7/25.06.2019	3,000,000	321/20.08.2020	1,500,000	1,500,000
Gusht 2020	113/16.04.2019	6,578,880	322/20.08.2020	1,578,880	5,000,000
Tetor 2020	113/16.04.2019	5,000,000	415/14.10.2020	2,000,000	3,000,000
		1,500,000	416/14.10.2020	1,500,000	0
Nëntor 2020	12.11.2020	3,076,000	459.12.11.2020	1,288,000	1,788,000
SHUMA		**43,902,236**		**15,967,767**	**27,934,469**

- *Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID 19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.*

Për përballimin e situatës "COVID-19" Bashkia Finiq ka përdorur fonde nga të ardhurat e veta të miratuar me urdhrin e Kryetarit nr. 20, datë 5.3.2020, për vlerën 4,485,050 lekë, *si më poshtë*:
Vlera prej 3,501,250 lekë është përdorur për dezinfektimin e ambienteve të Bashkisë Finiq, shkollave shesheve etj, kjo sipas urdhër shpenzimi nr. 169, datë 22.4.2020, për faturën nr. 20, datë 16.4.2020 në vlerën 1,209,750 lekë, urdhër shpenzimi nr. 299, datë 22.7.2020, për faturën nr. 22, datë 9.6.2020 në vlerën 793,500 lekë, urdhër shpenzimi nr. 345, datë 24.8.2020, për faturën nr. 25, datë 27.6.2020 në vlerën 1,498,000 lekë, përfitues subjekti "F A".

Materiale pastrimi urdhër shpenzimi nr. 402, datë 15.10.2020, në vlerën 176,400 lekë, urdhër shpenzimi nr. 506, datë 17.12.2020, në vlerën 257,400 lekë, përfitues subjekti "G K".

Blerje ushqime urdhër shpenzimi nr. 507, datë 16.12.2020, për faturën nr. 656, datë 23.11.2020 në vlerën 550,000 lekë, me FH nr. 62, datë 23.11.2020.

Ndihma nga DRRMSH me FD nr. 193, 195, datë 22.9.2020 në vlerën 89,053 lekë dhe FH e bashkisë nr. 54, 55, datë 22.09.2020 për vlerën 89,053 lekë për ushqime.
Gjithsej vlera për përdorimin e fondeve për përballimin e situatës "COVID-19" për vitin 2020 **është për vlerën 4,565,103 lekë.**

1.5. Mbi dokumentacionin mbi çeljen dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga të dhënat e paraqitura për periudhën objekt auditimi rezulton se Bashkia Finiq nuk ka procedura prokurimi për fonde të FZHR, nuk ka objekte në zbatim nga fondet e FZHR dhe nuk ka fatura të palikuiduara nga investimet e kryera me fondet e FZHR.

1. Titulli i Gjetjes: *Në Bashkinë Finiq u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, për pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre.*

Situata:
Për vitin 2020, sipas akt-rakordimin me Degën e Thesarit Delvinë, shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 647,838 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 642,886 mijë lekë ose në masën 99 %, sipas artikujve: *paga në masën 97%, sigurime në masën 97 %, shpenzime operative në masën 98 %, dhe investime në masën 100 %.*
Sipas burimeve të financimit për vitin 2020, **nga transferta e pakushtëzuar** (grandi) treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 133,563 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 133,563 mijë lekë ose në masën 100 %.
Nga këto investime nga 39,394 mijë lekë planifikuar, janë realizuar në vlerën 39,394 mijë lekë ose në masën 100 %.
Nga të ardhurat e trashëguara dhe të ardhurat e vitit, treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 64,478 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 64,478 mijë lekë ose në masën 100 %.
Nga transferta e pakushtëzuar dhe fondet e deleguara treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 449,797 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 444,845 mijë lekë ose në masën 99 %.
Nga analiza e tyre për pjesën e të ardhurave u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, kështu nga të ardhurat veta, të vitit dhe ato të trashëguara të planifikuara për vlerën 93,730 mijë lekë janë realizuar gjatë vitit 2020 në vlerën 64,478 mijë lekë e këto të fundit të alokuara në buxhetin e vitit 2020 pra për diferencën **29,252 mijë lekë**, diferencë e cila ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve kryesisht për investime me të njëjtën vlerë.
Kriteri:
Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" nenet 42, 43, 47, 50, 52 dhe 65; Udhëzimi i MF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit" i ndryshuar, pikat 253, 354; Udhëzimit të MF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91 dhe ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 40 dhe 48, si dhe vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.
Ndikimi/Efekti :
Planifikimi i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre, kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, sjellin mungesa në

plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

Shkaku:

Analizat e punës për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetet paraardhëse nuk janë bërë të plota, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve gjatë viteve.

Rëndësia: ***E lartë*****.**

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin e të Ardhurave, të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

2. Titulli i Gjetjes: *Në Bashkinë Finiq u konstatua se në buxhetin e vitit 2020 nuk janë programuar si zë më vete likuidimi i detyrimeve për fatura të palikuiduara, si dhe nuk është ndjekur radha e likuidimit të tyre dhe ka raste kur ato nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë.*

Situata:

Në buxhetin e miratuar për vitin 2020, u konstatua se nuk janë programuar si zë më vete, likuidimi i të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguara nga viti paraardhës, ku sipas pasqyrave financiare për vitin 2019, janë në shumën totale **134,462,229 lekë** ose 41 % e buxhetit fillestarë, nga të cilat:

Vlera 92,743,378 lekë, llogaria 467- Kreditorë të ndryshëm,

Vlera 41,718,851 lekë, llogaria 401-408- Furnitor e llogari lidhura me to,

Për vitin 2020 janë parashikuar si zë më vete vetëm detyrimet për vlerën 55,222 mijë lekë nga 134,462 mijë lekë ose 41%. Ndërsa në fund të vitit 2020, sipas pasqyrave financiare janë në shumën totale **65,375,633 lekë** nga këto:

Llogaritë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" për vlerën 5,013,123 lekë e analizuar për 15 subjekte dhe llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" për vlerën 60,362,510 lekë, e analizuar për 29 subjekte, sipas ***Aneks nr. 2.1,*** *bashkëlidhur Raport Auditimit.*

Deri me datë 30.09.2021 nga totali i *faturave* të palikuiduara në fund të viti 2020 për vlerën **65,375,633** lekë, është likuiduar gjithsej vlera 22,255,487 lekë, duke mbetur për likuidim vlera prej **42,120,146 lekë,** që i përkasin llog (*467*) "*Kreditorë të ndryshëm*", *sipas* ***Aneks nr. 2.2,*** *bashkëlidhur Raport Auditimit.*

Nga auditimi i pagesave për shpenzime operative/ investime/ etj, të realizuara nga ana e Bashkisë Finiq, për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020, u konstatua se nuk janë likuiduar gjithsej 122 fatura në vlerën 18,954,299 lekë brenda afatit **30 ditorë** nga momenti i paraqitjes se tyre.

Ndërsa në lidhje me mos likuidimin e plotë të vlerës së faturës për shpenzime operative/ investime/ etj, të realizuara nga ana e Bashkisë Finiq, për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020, u konstatua se nuk janë likuiduar gjithsej 17 raste, ku nga vlera e faturave të paraqitur për likuidim prej 43,902 mijë lekë është likuiduar vlera prej 15,967 mijë lekë, duke mbetur për likuidim vlera 27,934 mijë lekë, *sipas* ***Aneks nr. 2.33,*** *bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Kriteri:

Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" nenet 42,43,47,50,52 dhe 65; Udhëzimit të MF nr. 2 datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit" i ndryshuar, pikat 253, 354; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 40, 48.

Ndikimi/Efekti:

Nuk është respektuar radha e likuidimit të detyrimeve për faturat e periudhave të mëparshme me buxhetin e vitit pasardhës, nuk është bërë analizë nga titullari i institucionit si dhe nxjerrja e përgjegjësisë administrative për detyrimet e prapambetura.

Shkaku:

Nga mos realizimi i të ardhurave.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Finiq, të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite për vlerën **42,120,146 lekë** dhe të hartojë një grafik likuidimesh, duke zbatuar radhën e pagesave.

III/2.1.6. **Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimorë**.

3. **Titulli i gjetjes***: Mosrealizim i të ardhurave dhe mos ndjekjen e plotë e procedurave ligjore për realizimin e tyre.*

Situata:

Paketat fiskale për vitin 2020 është miratuar me Vendim të KB nr. 20, datë 6.12.2019 "Mbi miratimin paketës fiskale për vitin 2020", shprehur ligjshmëria nga Prefektura e Qarkut Vlorë me shkresë nr. 1966/1, datë 29.12.2019.

Gjatë vitit paketës fiskale i janë bërë ndryshime me Vendim të KB nr. 9, datë 29.4.2020, "Mbi miratimin e disa ndryshimeve ne paketën fiskale për vitin 2020" për uljen e taksës së pastrimit për shkak të situatës së krijuar nga "COVID-19". Plani i të ardhurave është korrigjuar në ulje nga 90,000 mijë lekë në 88,976 mijë lekë.

Bashkia Finiq ka miratuar treguesit e planit për vitin 2020 të cilat janë realizuar sipas të dhënave të ***Aneks nr. 2.4,*** *bashkëlidhur Raport Auditimit.*

Kështu për vitin 2020, të ardhurat nga taksat e tarifat vendore nga vlera 88,976 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 64,478 mijë lekë ose 72%, **me një mosrealizim në vlerën 24,498 mijë lekë.**

Me mosrealizim më të dukshëm paraqitet:

-Taksa e tokës bujqësore, ku nga vlera 28,102 mijë lekë e parashikuar, është realizuar në vlerën 13,359 mijë lekë ose 14 %, me mosrealizim **në vlerën 14,743 mijë lekë**, ose 16% e planit të të ardhurave.

-Taksa mbi ndërtesat, ku nga vlera 10,093 mijë lekë e parashikuar, është realizuar në vlerën 6,750 mijë lekë ose 67 %, me mosrealizim **në vlerën 3,343 mijë lekë**, ose 3.7% e planit të të ardhurave.

Kriteri:

Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale, etj.

Ndikim/Efekti:

Mungesa e të ardhurave sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njësisë së Qeverisjes Vendore.

Shkaku:

Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë taksat dhe tarifat vendore nga strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Nga Bashkia Finiq të merren masa për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të bëhet një analizë e hollësishme për planifikimin sa më real të të ardhurave për të mos krijuar diferenca të dukshme në realizimin e shpenzimeve buxhetore, kjo duke u mbështetur në burimet e krijimit të të ardhurave.

4. Titulli i Gjetjes*: Mos ndjekjen e plotë e procedurave ligjore për mbledhjen e detyrimeve debitorë.*

Situata:

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2020 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjekte fizik/juridik për vlerën 15,332 mijë lekë dhe me datë 31.12.2020 popullata për taksë toke, taksë ndërtese dhe tarifa vendore, në vlerën gjithsej prej 157,346 mijë lekë, **gjithsej në vlerën 172,678 mijë lekë,** sipas të dhënave si më poshtë:

Në 000/lekë

Lëvizja e Debitorëve	Subjekte juridik/Institucioni Shtetërore		Subjekte fizik		Abonentë familjare		Totali	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlere
Gjendje 31.12.2019	56	9,218	148	5,524	4,539	121,157	**4,743**	**135,899**
Shtuar Viti 2020	71	8,830	128	3,734	3,538	63,895	**3,737**	**76,459**
Pakësuar viti 2020	71	9,127	108	2,847	2,771	27,706	**2,950**	**39,680**
Gjendje me 31.12.2020	**56**	**8,921**	**168**	**6,411**	**5,306**	**157,346**	**5,530**	**172,678**

Sektori i të Ardhurave, në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (me ndryshime), për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI-*"Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara",* të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore", me ndryshime.

Kështu për vitin 2020, për 115 subjekte është dërguar bankave për bllokim llogarish për vlerën 15,630,288 leke, ku janë arkëtuar detyrime për 25 subjekte me vlerë 2,516,612 lekë, janë dërguar lista me subjekte debitorë ASHK për vlerën 9,177,874 lekë, ku janë arkëtuar 2,431,755 lekë.

Subjektet debitorë aktiv, pra kryejnë biznes, konstatohet se ndaj këtyre subjekteve për asnjë rast nuk është zbatuar pika 2 e nenit 89, e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (me ndryshime).

Kriteri:

Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale, etj.

Ndikimi/Efekti:

Mungesa e të ardhurave sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njësisë së Qeverisjes Vendore.

Shkaku:
Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë taksat dhe tarifat vendore nga strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore.
Rëndësia: E lartë
Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, , të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të periudhës në vlerën **172,678,000 lekë**, **si më poshtë vijon:**

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare,.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),.

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

III/2.2. Vlerësim i raportimit financiar për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë.

Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2020.
Në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 8 datë 9.3.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Delvinë me shkresën nr. 665 prot., datë 08.03.2021 *(Bashkëngjitur Raport Auditmit Aneks 2.2.1)*

- Baza ligjore (për vitin 2020).
Hartimi i pasqyrave financiare, është bazuar në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, shfuqizuar me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Vendimin e KM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre" i ndryshuar me Vendimin e KM nr. 25, datë 20.01.2001, Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" etj. legjislacion rregullues.

Mbajtja e kontabilitetit.
Në këtë Bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale, pa program elektronik. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, magazinën, arkën dhe ditari i veprimeve të ndryshme.

Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave.

Llogaritë kryesore të rakordueshme me Degën e Thesarit Delvinë , ***llogaria 520*** "*Disponilitete në Thesar"*, është në pasqyrat financiare për vlerën debitorë 35,596,221 lekë, e analizuar si vijon:

I. Të trashëguara nga viti 2019.	
Sipas akt rakordimit për vlerën.....	**26,452,987 lekë**
Grand i trashëguar.....	2,512,790 lekë
Të ardhura të trashëguara.....	3,462,996 lekë
Mjete ne ruajtje të trashëguara.....	20,477,201 lekë
II. Të hyra (shtesat debitorë) gjatë vitit 2020	
Granit i vitit.....	133,537,682 lekë
Të ardhurat e vitit.....	64,477,884 lekë
Të hyra nga mjete ne ruajtje.....	14,977,730 lekë
Granit sektorial.....	311,320,487 lekë
FShZh.....	24,622,180 lekë
Subvencione për Ujësjellësin.....	324,976 lekë
Paaftësia.....	103,466,680 lekë
Gjendja civile.....	4,082,000 lekë
Shuma e hyrjeve gjatë vitit ushtrimor.....	**656,809,619 lekë**
Totali i (Hyrjet debitorë) për vitin 2020 (I+II)=26,452,987+656,809,619. =	**683,262,606 lekë**
III. Lëvizjet kreditore të llogarisë:	
Mjete në ruajtje.....	4,645,611 lekë
Paga, sig. Shoq.....	131,740,461 lekë
Shpenzime operative.....	71,567,059 lekë
Transferta ujësjellësi.....	324,976 lekë
Ndihmë ekonomike.....	104,075,580 lekë
Investime	334,146,895 lekë
Këshilli Qarkut+tatime.....	1,002,270 lekë
Derdhur në buxhet.....	163,533 lekë
Totali i shpenzimeve (lëvizjet kreditore).....	**647,666,385 lekë**

Gjendja debitorë (Saldo debitor) në fund të vitit 2020, është (683,262,606 – 647,666,385 = **35,596,221 lekë.**

Analiza mbi lëvizjen debitorë të kësaj llogarie në shumën totale 35,596,221 lekë, është si vijon:

I. Të trashëguara. Gjendja ne fund te vitit 2020 paraqitet si më poshtë vijon:

Grand (p/kushtëzuar+sektorial)i trashëguar.....	2,168,881 lekë
Të ardhura të trashëguara.....	2,617,990 lekë
Mjete në ruajtje të trashëguara	30,809,350 lekë

Po kështu ***llogaria 466*** "*Kreditorë për mjetet në ruajtje*" në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 30,809,350 lekë sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit.
Kjo llogari çelje në fillim të vitit në vlerën 20,477,231 lekë, është shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën 14,977,730 lekë - 4,645,611 lekë që janë çngurtësimi gjatë vitit = 30,809,350 lekë *(Aneks Nr. 2.2.2, bashkëlidhur Raport Auditimit)*

Sa më sipër, llogaria 466 "*Kreditorë për mjetet në ruajtje*" për vlerën kontabël 30,809,350 lekë, sipas analizës për vitin 2020 është shtuar për 12 objekte për vlerën 14,977,730 lekë, duke u pakësuar në një rast për vlerën 4,645,611 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde për vlerën 20,477,231 lekë, ngurtësime të viteve 2019 e para, të cilave u ka kaluar afati i garancisë.

Bashkia Finiq nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për c'bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për interes publik, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

-Rakordimi i llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe llogarive të Aktiveve Qarkulluese me rezultatet e inventarizimit fizik v. 2020:

Për vitin 2020, ka dalë urdhri i Kryetarit të Bashkisë Finiq nr. 5210, datë 01.12.2020 "Për krijimin e komisioneve të inventarizimit të aktiveve", i cili është kryer vetëm për aktivet e llogarive 218- *Inventar ekonomik* si dhe llogarisë 327- *Objekte inventar*, **duke mos kryer inventarizimi për aktivet e tjera.**

Në përfundim të procesit të inventarizimit nga L M nuk janë përgatitur pasqyra përmbledhëse për gjendjen kontabël e fizike sipas rezultateve të inventarizimeve.
Në këto kushte, llogaritë e pasqyrave financiare, nuk janë të rakorduar me gjendjen fizike gjë e cila nuk krijon besueshmëri mbi vërtetësinë e pasqyrave financiare pa kryer inventarizimin fizik të gjithë Aseteve, veprime në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyra financiare" i ndryshuar, Kreu II, neni 7 ku citohet: *"1. Njësitë ekonomike, subjekte te këtij ligji, duhet te kontrollojnë, te paktën një here ne vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, te detyrimeve dhe te kapitaleve te veta, nëpërmjet inventarizimit te këtyre elementeve dhe evidencës se tyre mbështetëse.*
2. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nen përgjegjësinë dhe sipas procedurave te miratuara nga organi i drejtimit te njësisë ekonomike, qe aktivet dhe detyrimet te paraqiten me vërtetësi dhe besueshmëri ne pasqyrat financiare vjetore.", **si dhe të Udhëzimit të MF nr. 8, datë 9.3.2018 "***Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme***" *Kreu III, pika 30 ku citohet: "Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konformë kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet*."

-Analiza e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive, llogaritë; 202, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32, Viti 2019.

U audituan gjendja analitike kontabël e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe Qarkulluese për koston historike për llogaritë si vijon:
-Llogaria 202 "*Studime dhe kërkime*", për vlerën kontabël historike 36,263,087 lekë, si për vitin 2019 ashtu dhe për vitin 2020.
-Llogaria 210 "*Toka, troje, terrene*", për vlerën kontabël historike 300,000 lekë. Gjatë vitit nuk ka pasur shtesa dhe pakësime.
-Llogaria 212 "*Ndërtime konstruksione*", për vlerën historike 287,364,625 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën debitorë (287,364,625 - 281,048,055) = 6,316,570 lekë për 2 objekte të analizuar si më poshtë vijon:

Referenca	Nr	Përshkrimi	Debi Leke
D. Veprimeve	1	Çelje datë 01.01.2020	281,048,055
	2	Rikonstruksion I Shkollës Vrion	1,945,100
	3	Rikonstruksion I Vatrës se Kultures Dhrovjan	4,371,470
		Shuma teprica datë 31.12.2019	**287,364,625**

-Llogaria 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*", për vlerën historike 1,378,906,559 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën debitorë (1,378,906,559 - 1,200,622,131) = 321,981,190 lekë për 14 objekte dhe është pakësuar për 40 objekte në vlerën 143,696 lekë, *të analizuar sipas Aneksit 2.2.3, bashkëlidhur Raport Auditimit.*

-Llogaria 214 *"Instalime teknike, makineri Paisje, vegla pune"*, për vlerën kontabël 92,050,482 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (92,050,482 - 78,208,562) = 13,841,920 lekë, *të analizuar sipas Aneksit 2.2.4, bashkëlidhur Raport Auditimit*.
-Llogaria 215 "Mjete transporti", për vlerën historike 80,831,485 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën debitorë (80,831,485 - 72,909,423) = 14,079,762 lekë për 4 mjete dhe është pakësuar për 3 mjete në vlerën 6,157,700 lekë, *të analizuar sipas Aneksit 2.2.5, bashkëlidhur Raport Auditimit.*
Kjo llogari është e analizuar për 31 mjete sipas të dhënave të pasqyrës si më poshtë,
-Llogaria 215 "Mjete transporti" për vlerën historike 80,831,485 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën debitorë (80,831,485 - 72,909,423) = 14,079,762 lekë për 4 mjete dhe është pakësuar për 3 mjete në vlerën 6,157,700 lekë, të analizuar sipas Aneksit 2.2.6, bashkëlidhur Raport Auditimit.

Nga sa trajtuar më sipër rezulton se llogaritë 210 "*Toka, troje, terrene*", 211 "*Pyje Plantacione*", 212 "*Ndërtesa e Konstruksione*", 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*", 214 "*Instalime teknike, makineri Paisje, vegla pune*" 215 "*Mjete transporti*", janë të paanalizuar në kontabilitet, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave, si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6; Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pikat 26-30, si dhe pikën 74, të Udhëzimit të MF nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".

Llogaria 2018 *"Inventar ekonomik"*, për vlerën historike 32,734,100 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (32,734,100 - 22,860,513) = 7,904,837 lekë, *të analizuar sipas Aneksit 2.2.7, bashkëlidhur Raport Auditimit.*
-Llogaria 31 "*Materiale*", për vlerën kontabël 4,628,475 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (4,628,475 - 3,164,776) = 1,463,649 lekë.
-Llogaria 32 "*Inventar i imët*", për vlerën kontabël 20,740,885 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për vlerën (20,740,885 – 20,678,925) = 61,960 lekë.
Gjendja e llog. 231 *"Shpenzime në proces për rritjen e AQT"* , në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likuidimin i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat nuk janë kryer pagesat, për vlerën 215,996,403 lekë.
Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0, kur ka investime në proces, kështu për Objektin " *Ujësjellësi rajonal Bashkisë Finiq linja e jashtme burimet e Merkos*" në vlerën 211,624,933 lekë dhe Llogarisë 212 "*Ndërtime konstruksione*" për objektin

"*Rikonstruksion i vatrës së kulturës Dhrovjan*" në vlerën 4,371,470 lekë, pra vlera e kësaj llogarie duhej pasqyruar në vlerën gjithsej 215,996,403 lekë.
Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Aneksi 1, Klasa 23.
Me përfundimin e ciklit të blerjes apo ndërtimit të aktiveve, **këto bëhen funksionale dhe kapitalizohet në grupet 20 e 21 të aktiveve të përfunduara.**

Klasa 4 "*Llogari të arkëtueshme*", paraqiten në mbyllje të bilancit të vitit 2020 në vlerën 220,375,608 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2019 në vlerën 147,286,182 lekë.

- **Analiza e llogarive debitorë viti 2020**

Në llogaritë financiare të vitit 2020, gjendja e llogarisë debitorë 468 "*Debitorë të ndryshëm*", paraqitet me vlerë kontabël 195,022,368 lekë Nga të dhënat që na u paraqitën, në këtë llogari janë evidentuar debitorët për tatim taksat lokale në vlerën 172,678,536 lekë, si dhe 53 debitorë të tjerë për vlerën 22,343,832 lekë analizuar në Aneks 2.1 të Raport Auditimit
- **Gjendja e llogarisë 4342 *"Operacione me shtetin (të drejta)"***, për vitin 2020 paraqitet në shumën 25,353,240 lekë, e cila përbëhet nga detyrime afatshkurtra për muajin dhjetor 2020, ku me analizë përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit, llog. 42 "*Detyrime ndaj personelit*" për vlerën 7,872,041 lekë, llog. 431 "*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa*" për vlerën 661,654 lekë, llog. 435 "*Sigurime shoqërore*" për vlerën 1,391,685 lekë, llog. 436 "*Sigurime shëndetësore*" për vlerën 157,768 lekë dhe faturat të mbërritura në dhjetor të vitit 2020 e të palikuiduara, në vlerën 15,270,092 lekë që i përkasin llogarisë 467 "*Kreditorë të ndryshëm*" dhe llogarisë 401-408 "*Furnitorë e llogari të lidhura me to*".
Klasa 4 "*Të tjera aktive afatshkurtra*" e cila përbëhet nga :
Gjendja e llogarisë 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*", në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 50,105,541 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2019 paraqitet në vlerën 134,462,229 lekë.
Nga auditivi u konstatua se për vitin 2020 gjendja e llogarisë 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*" në aktiv **nuk rakordon** me gjendjen e llogarisë kundërparti 467 "*Kreditorë të ndryshëm*" dhe llogarinë 401-408 "*Furnitorë e llogari të lidhura me to*", në pasiv të bilancit e cila paraqitet për vlerën 65,375,633 lekë, **për faktin se diferenca për vlerën 15,270,092 lekë është pasqyruar në aktiv në llogarinë *4342 "Operacione me shtetin (të drejta)"***, sipas Udhëzimit të MFE nr. 37, datë 6.10.2020 "Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme". Kjo procedurë është në papajtueshmëri me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kreu II "*Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" pika 5, pasi këto fatura në fakt përfaqësojnë borxhin që Bashkia Finiq ka ndaj subjekteve të ndryshme. **Në këtë rast kemi mos pasqyrim të saktë të borxhit për fatura të palikuiduara në pasqyrat financiare të vitit 2020**.

- *Analiza e llogarive kreditore viti 2020*

Gjendja e llogarive kreditore, është si më poshtë vijon:
Llogaritë 401-408 "*Furnitorë e llogari të lidhura me to*" për vlerën 5,013,123 lekë e analizuar për 15 subjekte dhe llogaria 467 "*Kreditorë të ndryshëm*" për vlerën 60,362,510 lekë, *të analizuar sipas Aneksit 2.2.8, bashkëlidhur Raport Auditimit.*

- *Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës .*

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Për vitin 2020, numri i punonjësve është miratuar me vendimi të Këshilli të Bashkisë nr. 30, datë 28.12.2019 për miratimin e numrit të punonjësve në total 192 punonjës nga të cilët 14 drejtues, 60 specialist dhe 118 teknik, nëpunës të thjeshtë dhe punëtorë, me fond page gjithsej 112,530,127 lekë.

- Mbi transferimin e Aseteve në "Ujësjellësin" Sha.

Me Vendim të KB nr. 4 datë 01.4.2016 me nr. Prot., 1057 datë 14.4.2016 dhe në zbatim të Vendimit të KM nr. 63 datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura", është miratuar krijimi i "Ujësjellësit" Sha me kapital tërësisht publik në vlerën 334,796,075 lekë.

Vlera e Aseteve që Bashkia Finiq do të investonte në këtë Shoqëri, është rivlerësuar nga ekspert vlerësues të pasurisë së paluajtshme të liçensuar me Vendim Gjykate nr. 23-2017-631(318) datë 4.4.2017 me nr. NIPT, I 76931502 F.

Konstatohet se Bashkia Finiq, ***ka transferuar në vitin 2020 asetet për "Ujësjellësin" Sha, gjithsej në shumën 143,696,762 lekë*** që i përkasin -Llogarisë 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*".

Transferta në natyrë, nuk janë bërë me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët, veprim në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik" pikat 35/a, b, 42, 44.

Për rrjedhojë, nuk janë bërë veprimet kontabël nga ana e Bashkisë Finiq dhe si rrjedhim, pasqyrat financiare të vitit 2019, nuk pasqyrojnë saktë gjendjen e Aseteve të Bashkisë Finiq si raportet financiare si aksionere në shoqërinë "Ujësjellës" sha, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik" pikat 35/a, b, 42, 44 dhe Udhëzimin e MF nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes se përgjithshme" Kap. II, neni 17.

1. Titulli gjetjes: *Mos kryerja e inventarizimit të aktiveve afatgjata*

Situata:

Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020, nuk është kryer inventari fizik i Aktiveve Afatgjata. Në kontabilitet llogaritë 210 "*Toka, troje, terrene*", 211 "*Pyje Plantacione*", 212 "*Ndërtesa e Konstruksione*", 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*", 214 "*Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune*" 215 "*Mjete transporti*", nuk janë të analizuara, nuk ka një

regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave, si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet.

Kriteri:

Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 5.

Ndikimi/Efekti: Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie.

Shkaku:

Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore në fuqi nga personat përgjegjës.

Rëndësia: ***I lartë***

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Finiq, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës, për inventarizimin e aktiveve të veta si: 210 "*Toka, troje, terrene*", 211 "*Pyje Plantacione*", 212 "*Ndërtesa e Konstruksione*", 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*", 215 "*Mjete transporti*", duke bërë dhe verifikimin në terren të këtyre Aseteve.

Për diferencat eventuale të konstatuara dhe për vlerat jashtë përdorimit nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemimin e llogarive kontabël.

2. Titulli i gjetjes: *Mbi mangësitë e konstatuara në llogarinë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme".*

Situata:

Për vitin 2020 gjendja e llogarisë 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*" në aktiv nuk rakordon me gjendjen e llogarisë kundërparti 467 "*Kreditorë të ndryshëm*" dhe llogarisë 401-408 "*Furnitor e llogari të lidhura me to*" në pasiv të bilancit e cila paraqitet për vlerën 65,375,633 lekë për faktin se diferenca për vlerën 15,270,092 lekë është pasqyruar në aktiv në llogarinë 4342 "*Operacione me shtetin (të drejta)*".

Kriteri:

Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 5.

Ndikimi/Efekti: Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie.

Shkaku:

Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore në fuqi nga personat përgjegjës.

Rëndësia: **I lartë**

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financës në Bashkinë Finiq, të marrë masa për sistemimet e llogarive me vlerat e tyre reale për llogarinë 4342 "*Operacione me shtetin (Te drejta)*", për vlerën 10,083,148 lekë dhe llogarinë 486 "*Shpenzime te periudhave te ardhshme*", për vlerën 65,375,633 lekë.

3. Titulli i gjetjes: *Mbi mangësitë e konstatuara në llogarinë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT".*

Situata:
Llogaria 231 "*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*" në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 0 (zero) lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se, për vitin 2020 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për llogarinë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" për Objektin " *Ujësjellësi rajonal Bashkisë Finiq linja e jashtme burimet e Merkos*" në vlerën 211,624,933 lekë dhe llogarisë 212 "*Ndërtime konstruksione*" për objektin "*Rikonstruksion i vatrës së kulturës Dhrovjan*" në vlerën 4,371,470 lekë. Pra vlera e llogarie 231 "*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*", duhej pasqyruar në vlerën gjithsej 215,996,403 lekë.

Kriteri:
Udhëzimin e MFE nr.8 datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Aneksi 1, Klasa 23.

Ndikimi/Efekti: Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie.

Shkaku:
Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore në fuqi nga personat përgjegjës.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financës në Bashkinë Finiq, të marrë masa për sistemimet e llogarive me vlerat e tyre reale, duke kredituar llogarinë 231"*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*", në vlerën 215,624,933 lekë dhe debituar llogarinë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" në vlerën 211,624,933 lekë dhe llogarinë 214 "*Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune*", për vlerën 4,371,470 lekë.

4. Titulli i gjetjes: *Mbi mangësitë e konstatuara në llogarinë 466 "Kreditorë për mjetet në ruajtje" në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 30,809,350 lekë.*

Situata:
Në fund të vitit 2020, llogaria 466 "*Kreditorë për mjetet në ruajtje*" në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 30,809,350 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit. Nga auditivi u konstatua se janë ngurtësuar fonde në vlerën 20,477,231 lekë që i përkasin ngurtësimeve të viteve 2019 e para të cilave u ka kaluar afati i garancisë. Bashkia Finiq nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për c'bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për interes publik.

Kriteri:
Udhëzimit të MF nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Ndikimi/Efekti: Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie.

Shkaku:

Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore në fuqi nga personat përgjegjës.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financës në Bashkinë Finiq, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2019 e para me vlerë 20,477,231 lekë, të cilave ju ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

5. Titulli i gjetjes: *Mbi transferimin e Aseteve në shoqërinë "Ujësjellës" sha.*

Situata:

Bashkia Finiq, ka transferuar në vitin 2020 asetet për "Ujësjellësin Sha" në shumën 143,696,762 lekë që i përkasin Llogarisë 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*". Nga vlera 334,796,075 lekë e rivlerësuar nga ekspert vlerësues të pasurisë së paluajtshme të liçensuar me Vendim Gjykate nr. 23-2017-631(318) datë 04.04.2017, transferime të cilat nuk janë bërë me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe nuk janë bërë veprimet kontabël, për rrjedhojë pasqyrat financiare të vitit 2020, nuk pasqyrojnë saktë gjendjen e Aseteve të Bashkisë Finiq si aksionere në Ndërmarrjen "Ujësjellës sha".

Kriteri:

UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik" pikat 35/a, b, 42, 44dhe Udhëzimit të MF nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes se përgjithshme" Kap. II, neni 17.

Ndikimi/Efekti: Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie.

Shkaku:

Mos zbatim i ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrejë një grup pune me specialist të fushës, për saktësimin e Aseteve që i përkasin "Ujësjellës sha" Finiq.

Të bëhet transferimi i tyre me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët dhe të kryhen veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: znj *L M* me detyrë Drejtor i Financës, për periudhën e objekt auditimi.

III/2.3. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Manualeve përkatëse të punimeve, udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik etj.

*3.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve***.**

Nga Bashkia Finiq janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.01.2020 – 30.6.2021. Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, me shkresa përcjellëse janë dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi mbështetur në Vendimet e KB përkatëse "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Finiq".
Në këto regjistra janë pasqyruar shtesat dhe ndryshimet e bëra sipas VKB –ve përkatëse, në përputhje me nenin 4 "*Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik*", pika 1. Dërgimi i regjistrit të parashikimeve në APP, është bërë brenda afateve të përcaktuara në Vendim i KM nr. 914, neni 4, pika 3.

1. Titulli gjetjes: *Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të prokuruar***:**

Situata:
Nga të dhënat e Drejtorisë së Financës, u konstatua se për periudhën 01.01.2020 deri më 30.6.2021 nga vlera e kontratave të lidhura prej 1,195,394 mijë lekë janë planifikuar për likuidim sipas periudhave deri më 30.6.2021 dhe miratuar në buxhet vlera 392,519 mijë lekë, duke likuiduar vlerën prej 291,568 mijë lekë dhe mbetur palikuiduara vlera **100,951 mijë lekë,** të dhëna të cilat paraqiten në tabela si vijon:

në 000/lekë**:**

Periudha ushtrimore	Vl. Kontratë lidhur	Planifikuar periudha	Likuiduar periudha	Pa likuiduar
Viti 2020	1,068,677	265,849	234,898	30,951
Viti 2021 (6 mujori pare)	126,717	126,670	56,670	70,000
TOTALI	**1,195,394**	**392,519**	**291,568**	**100,951**

***Burimi*:** *Nga të dhënat e Bashkisë Finiq*

Nga të dhënat e tabelës, konstatohet se Bashkia Finiq planifikon procedura në mungesë të realizmit të të ardhurave, pasi megjithëse ka kontrata të palikuiduara nga periudha në periudhë, vijon me planifikimin e procedurave të reja pa një studim të mirëfilltë të fondeve në përdorim, **veprime të cilat në fund çojnë në rritjen e borxhit për faturat e palikuiduara.**
Të dhënat e mësipërme tregojnë situatën e vështirë financiare e kësaj bashkie në likuidimet e vlerës së faturave të paraqitura për likuidim dhe njëkohësit rritjen e nivelit të detyrimeve kreditorë në fund të periudhave ushtrimore.

Kriteri:
UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91; Ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 40, 48: Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52.

Shkaku:
Likuidim me vonese i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh, si dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh dhe financim të investimeve.

Ndikimi/Efekti:
Mos likuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të palikuiduara dhe vënien në vështirësi për realizimin e objektivave në vitin vijues.

Rëndësia: ***I lartë***

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike gjatë hartimit të buxheteve, planifikimi i procedurave të prokurimit të jetë në raport me nivelin e të ardhurave të realizuara për vitin dhe grandeve të planifikuara nga

buxheti qendror dhe jo në raport me të ardhurat e parashikuara për vitin ushtrimorë.

- *Të dhënat për burimet e financimit të fondeve të prokuruar.*

Tabela nr. 3, Për vitet 2020 -2021 shprehur në lekë

EMËRTIMI	Vlera kontratës	Në %
Grande pakushtëzuara	33,796,975	2.69
Nga të ardhurat e bashkisë	19,634,381	1.56
Grande + të ardhura bashkia	18,014,461	1.44
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1,113,796,422	94.3
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	51,920,560	
Transferta specifike	17,939,497	
Total kontrata viti 2020	**1,255,102,296**	

Burimi*: *Nga të dhënat e Bashkisë Finiq

Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se nga vlera totale e fondeve të prokuruar prej 1,255,102 mijë lekë, u konstatua se janë planifikuar me grande pakushtëzuara vlera 33,796 mijë lekë ose 2.69%, me transferta specifike vlera 1,183,656 mijë lekë ose 94.3%, me të ardhurat e veta vlera 19,634 mijë lekë ose 1.56% dhe me të ardhurat + grande vlera 18,014 mijë lekë ose 1.44%.

- Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, u konstatuan se*:*

Në 000/lekë.

Lloji i procedurës	Nr. Proc	Fondi limit	vlera e ofertave fituese	Diferenca nga fondi limit	diferenca nga fondi limit në %
Hapura	8	1,270,375	1,202,933	67,442	5.31
Kërkesë me propozim	15	47,522	43,370	4,152	8.74
SHUMA	***23***	***1,317,897***	***1,246,303***	***71,594***	***5.4***
Vlerësuara per auditim					
Hapura	8	1,270,375	1,202,933	100	100
Kërkesë me propozim	0	0	0	0.0	0.0
SHUMA	***8***	***1,270,375***	***1,202,933***	***96***	***96.52***

***Burimi** i të dhënave: Bashkia Finiq*

Sipas llojit të aktivitetit për periudhën 01.01.2020 – 30.6.2021, u konstatua se në fushën e investimeve (ndërtim) janë realizuar gjithsej 16 procedura me fond limit 1,283,331 mijë lekë ose 97.3% e fondit të prokuruar. Ndërsa në fushat e tjera janë gjithsej 7 procedura me fond limit 34,566 mijë lekë ose 2.6% e fondit të prokuruar.

Titulli gjetjes 2: *Në zbatimin e procedurave të prokurimit të periudhës 01.01.2020 – 30.6.2021, u konstatuan shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, si në aplikimin e kritereve dhe shpalljen fitues të OE.*

Situata:

Referuar të dhënave të regjistrit të procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2020 deri më 30.6.2021, janë realizuar gjithsej **23** procedura me fond limit 1,317,897 mijë lekë dhe vlerë kontrate 1,246,303 mijë lekë, me ulje për vlerën 71,594 mijë lekë ose 5.4%.
Grupi i KLSH-së, referuar vlerësimit të të dhënave të materialitetit nga 23 procedura me fond limit 1,317,897 mijë lekë ka vlerësuar për auditim **8** procedura me fond limit 1,285,942 mijë lekë ose 97.5% të fondit të prokuruar. Pjesëmarrës në procedura, janë gjithsej 71 OE, nga të cilët janë skualifikuar 24 OE.
Nga auditimi i **8** procedura me fond limit 1,285,942, janë konstatuara në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej **7** procedura me vlerë të fondit limit 660,296 mijë lekë *(të dhëna të paraqitura në Aneks 2.4 të Raport Auditmit)*, shkelje të cilat kanë konsistuar në këto mangësi:

a- Në **6 raste**, kriteret nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore të LPP, pasi janë aplikuar kritere jo sipas llojit të procedurës dhe të paargumentuara

b- Në **1 raste**, OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK, ku procedurat duheshin anuluar dhe zhvilluar procedura të tjera me kushte më të favorshme për të siguruar përdorimin me efektivitet, efiçencë dhe ekonomicitet (3-E) të fondeve të prokuruar.

Kriteri:

a- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar:

- **Neni 2,** *"Parimet e përzgjedhjeje",* ku thuhet se:

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:
a) mos diskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;
b) transparencë në procedurat e prokurimit;
c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.

- **Neni 24,** *"Anulimi i një procedure",* ku theksohet se:

1. *Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm:*
a) për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik;
b) nëse nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore;
c) kur në fazën e parë të procedurës së kufizuar dhe me negocim me shpallje paraprake të njoftimit kualifikohen më pak se 2 kandidatë;
ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit;
d) nëse të gjitha ofertat e paraqitura përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar;
dh) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave "b" dhe "ç" të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji

- **Neni 46,** *"Kualifikimi i ofertuesve"*, pika 1, ku është përcaktuar se**:**

"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese:…".

- **Neni 47**, "*S`kualifikimi i ofertuesve*", ku është përcaktuar se:

"Autoriteti kontraktor s`kualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në fazën e shpalljes së kontratës fituese. Autoriteti kontraktor për çdo s`kualifikim raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik për qëllimet e parashikuara në nenin 13 pika 3 të këtij ligji.

- **Neni 53,** *"Shqyrtimi i ofertave",* ku është përcaktuar se:

"1. Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e

parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme".

- **Neni 55,** *"Kriteret e përcaktimit të ofertës",* ku thuhet se:

2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.
3. Vlerësimi i ofertave bëhet vetëm në baza teknike dhe ekonomike.

- **Neni 58,** *"Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës"***,** pika 1, ku është përcaktuar se:

"1. Njoftimi i fituesit i jepet menjëherë ofertuesit, që ka paraqitur ofertën më të mirë, në përputhje me nenin 55 të këtij ligji".

b- Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nenet:

- **Neni 26**, "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 5, ku është përcaktuar se:

"Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

- **Neni 66**, "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", ku është përcaktuar se:

"1. Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.
Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.

- **Neni 67**, *"Klasifikimi i ofertave",* ku është përcaktuar se:

"Në bazë të ofertave të pranuara, komisioni i vlerësimit të ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili u komunikohet ofertuesve në kohën e përcaktuar në këto rregulla".

- **Neni 69**, *"Njoftimi i fituesit",* ku është përcaktuar se:

"*Pas miratimit të raportit përmbledhës, autoriteti kontraktor dërgon për publikim në faqen e internetit të APP-së dhe Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e fituesit në përputhje me nenin 58 të LPP****".***

- **Neni 70** *"Lidhja e kontratës",* ku është përcaktuar se:

"Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor".

- **Neni 78 "***Ankesat në autoritetin kontraktor,* ku është përcaktuar se:

3. Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm:
a- Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës[5] *për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përjashtimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm, i cili duhet të jetë ekspert fushe. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës.*

Ndikimi/Efekti:

Aplikimi i kritereve jo në mënyrë të argumentuar dhe në përputhje me procedurën, si dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kritereve të DST, janë veprime në

[5] *Shtuar me vendimin Nr. 797, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, "për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.*

paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike për vlerën 266,329 mijë lekë pa t.v.sh., për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT dhe KVO sipas procedurave trajtuar në vijim për periudhën 01.01.2020 – 30.6.2021.

Shkaku:

Mos njohja e kuadrit ligjorë zbatues në fuqi, në aplikimin e kritereve dhe shpalljen fitues të OE me mangësi.

Shkaku:

Mos njohja e kuadrit ligjorë zbatues në fuqi, në aplikimin e kritereve dhe shpalljen fitues të OE me mangësi.

Rëndësia: ***E lartë***

Për këtë rekomandojmë :

Kryetari i Bashkisë Finiq, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për aplikimin e kritereve në mënyrë të paargumentuar dhe jo në përputhje me procedurat e zhvilluara, si dhe të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të kritereve të miratuara në DT, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik pa ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet (3-E).

- **Mbi procedurat e prokurimit të audituara në periudhën 01.01.2020 – 30.6.2021**

1- Procedura e prokurimit me objekt *"**Ujësjellësi Rajonale i Finiqit (linja e jashtme), Burimet e Merkos, ndërtim montime makineri e Paisje**",* me këto të dhëna:

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës me objekt "Ujësjellësi Rajonale i Finiqit (linja e jashtme), Burimet e Merkos, ndërtim montime makineri e Paisje".</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi Nr. 5, datë 5.3.2020</td><td rowspan="2">3. Njësia e Prokurimit
L K
Th F
S Sh</td><td rowspan="2">4. Komisioni VO nr. 5/1, datë 5.3.2020
K Th
K M
A M</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Hapur",</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa T.v.sh.)
469,080,695 lekë.
REF-53692-03-10-2020</td><td>6. Oferta fituese (pa T.v.sh.) "SH F" sh.a. me vlerën e ofertës 466,528,839 lekë pa T.v.sh..</td><td>7. Diferenca me fondin limit (pa T.v.sh.) 2,552mijë lekë pa T.v.sh. ose 0.54 %</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
15.4.2020</td><td>9. Burimi Financimit
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.</td><td>10. Operatorë Ekonomike pjesëmarrës 2 OE:
Skualifikuar 1 OE
Kualifikuar 1 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime
AK-ka;</td><td>12. Përgjigje Ankesës nga AK</td><td>13. Përgjigje KPP</td></tr>
<tr><td colspan="3">b. Kontrata</td></tr>
<tr><td>14. Lidhja e kontratës
Nr. 1306, Datë 29.4.2020</td><td>15. Vlera e kontratës (me T.v.sh.)
466,528,839 lekë me afat 24 muaj.</td><td></td></tr>
</table>

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditimi në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me shkresat nr. 417, datë 11.2.2020 dhe nr. 500, datë 14.2.2020 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë *(Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve*)", është miratuar fondi në vlerën 469,080,695 lekë pa t.v.sh, i cili do financohet në 4 periudha ushtrimore, si vijon:

Për vitin 2020 shuma 111,624,933 lekë;

Në vitin 2021 në shumën 111,624,933 lekë;

Në vitin 2022 në shumën 334,874,798 lekë.

Me shkresën nr. 596/1, datë 24.2.2020, Bashkia Finiq i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, lidhur me procedurë me objekt *"Ujësjellësi Rajonale i Finiqit (linja e jashtme), Burimet e Merkos, ndërtim montime makineri e Paisje",* që Bashkia Finiq po zhvillon, për mungesë stafi në këtë bashki, kërkohet të punësohet me kontratë 1 (një) ekspert i jashtëm si anëtarë i KVO, kjo në zbatim të nenit 58 të VKM nr. 614, datë 29.12.2014, me ndryshime.
Me shkresën nr. 3091/1, datë 7.12.2020 nga Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve është kthyer përgjigje Bashkisë Finiq, duke propozuar si pjesë të KVO ing. A Ç me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Projektimit dhe Oponencës në Drejtorinë e Planifikimit të Investimeve, për të cilën është lidhur kontrata e shërbimit nr. 3981/2, datë 4.12.2020.
Për objektin është lëshuar leje zhvillimore nr. 02, datë 27.4.2020 për Bashkimin e OE "Sh F" me licensë nr. NZ 1495/22 & NZ 1163/18

Me shkresën nr. 927/2, datë 6.01.2020 nga Instituti i Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është dërguar oponenca teknike për objektin *"Ujësjellësi Rajonale i Finiqit (linja e jashtme), Burimet e Merkos, ndërtim montime makineri e Paisje"*.
Në përfundim është konkluduar se projekti i *"Ujësjellësi Rajonale i Finiqit (linja e jashtme), Burimet e Merkos, ndërtim montime makineri e Paisje",* plotëson kushtet teknike të projektit, sipas konkluzioneve të dhëna për këtë oponencë teknike dhe të plotësuara para zbatimit të punimeve.

Projekt/preventivi është hartuar me procedurë prokurimi nga shoqëria "*H*", miratuar me Vendim të AKUM nr. 40, datë 15.9.2020, ku si referencë e cimeve është bazuar në Vendimin e KM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të punimeve të ndërtimit dhe analiza teknike të tyre". Për zërat që nuk janë në manual është hartuar analiza teknike e çmimeve nga projektuesi.

-ANKESA
Nga subjekti "6DP" sh.p.k sipas shtojcës 21, me datë 12.3.2020 *(prot Bashkia Finiq nr. 1021, datë 19.3.2021)*, është paraqitur ankesë në lidhje me aplikimin e kritereve.
Me shkresën nr. 75/1, datë 18.3.2020 nga shoqëria "6DP" sh.p.k është paraqitur kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi i ankesës, kjo me pretendimin se nuk do marrë pjesë në këtë procedurë.
Me urdhër të titullarit të AK nr. 36, datë 19.3.2020 është ngritur KSHA i përbërë nga A K, K Th dhe S Ç.
Nga NJHDT Bashkia Finiq me shkresën nr. 1031, datë 20.3.2020 është kthyer përgjigje shoqërisë "6DP" sh.p.k , mbi pretendimet për kriteret e aplikuara, duke kundërshtuar se ankesa është jashtë afateve ligjore të përcaktuara në pikën 1 e nenit 63 të LPP.

- Vlerësimi i kritereve:
Në hartimin e DST në lidhje me kriteret rezulton se, nuk ka gjetur zbatim Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26 "*Kontratat për punë publike*", pika 7 dhe neni 61, "*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*", pika 2, paragrafi 2, si dhe nuk kanë mbështetje ligjore kërkesat në lidhje me sa vijon:

a- **Në pikën 2.3.3 të DST** mbi kategorinë e licensave, janë të paargumentuar licensa NP-1/D-*Punime gërmimi në tokë*; NP-5/C- *Punime nëntokësore, ura e vepra arti*; NP-7/F- *Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi*; NP-9/D- *Punime për mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime*; NP-10/B- *Ndërtim impianteve për prodhim energjisë elektrike* dhe NP-11/C- *Ndërtime dhe për punime*

speciale kategoritë NS-8/D- *Ndërtime parafabrikate beton arme, struktura metalike dhe druri*; NS-9/D- *Punime strukturore speciale*; NS-10/E- *Shtresa dhe mbi struktura speciale*; NS-16/C- *Ndërtime të impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij* dhe NS-20/C- *Shpime gjeologjike-inxhinierike, puse e shpime për ujë,* pasi këto kategori punimesh nuk kanë lidhje me zërat e preventivit të kësaj procedure dhe se kategoritë e kërkuara, volume i punimeve që ato përfaqësojnë nuk përkon me volumin e punimeve sipas zërave të preventivit që ato përfaqësojnë.

b- **Kërkesa për mjek për periudhën** Shkurt 2019 – Janar 2020, e cila nuk është në përputhje me përcaktimet e VKM 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojë punëmarrësit, personat dhe shërbimet specializuara që merren ....", ku parashikohet mënyra e sigurt të shërbimeve mjekësore, në raport me numrin r punonjësve të punësuar;

Nga sa sipër shihet një numri i lartë e inxhinierëve të kërkuar për të cilën nuk ka një argumentim. Nuk kuptohet pse kërkohet arkitekt pejzash, pasi nuk kemi të bëjmë me objekte ndërtimi apo rikonstruksione sheshesh, por është thjeshtë riparim rruge.

Kërkesa për mjek është e tepërt dhe nuk ka lidhje me asnjë nga përcaktimet e kontratës dhe është në kundërshtim me VKM nr. 632, datë 15.07.2015, e cila ka ndryshuar VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, ku përcaktohet se:

"Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje, si më poshtë vijon: "6. Punëdhënësit e grupeve "A" dhe "B", në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve "C" dhe "D", për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë".

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të Vendim i KM nr. 914, datë 24.12.2014 "Për rregullat e Prokurimit Publik".

c- **Në pikën 3.3.3.4 të DST**, është kërkuar që OE të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar për: **1 (një) Inxhinier elektroteknik, drejtime Automjeti; 2 inxhinier Topograf (marksheder) dhe 2 ing. Mjedisi,** ku njëri të jetë me profil për trajtimin e ujërave dhe tjetri i pajisur me certifikatë të lëshuar nga Ministria e Mjedisit për vlerësim në Mjedis.

Kërkesat e mësipërme janë jo të mirë argumentuara, pasi referuar tipologjisë së objektit dhe zërave të preventivit nuk ka punime që lidhjet me profesionin e inxhinierëve të kërkuar. Nuk kuptohet se pse duhet që ing. Elektronik të lejë në liçensën e shoqërisë dhe ky me profil "Drejtim Automatike".

Kërkesa që ing. Topograf të jetë **Marksheder,** është i paracaktuar për kompanitë pjesëmarrëse.

Kërkesa që ing. Mjedisit të jenë të profilit të ujërave dhe tjetri i pajisur me certifikatë VNM nga Ministria e Mjedisit, është një kriter që paracakton kompanitë pjesëmarrëse

d- **Kërkesa që OE pjesëmarrës të** kenë **1 (një) Inxhinier Auditues i Energjisë** *(i pajisur me certifikatë për auditimin e energjisë),* e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Aplikimi i këtij kriteri, marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do realizohen, konstatohet se nuk ka parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për të cilat këto kritere janë të nevojshme, veprime në kundërshtim me pikën 1 e nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.

Aplikimi i kësaj kërkesë është totalisht i paargumentuar dhe i fryrë, pasi po nga AK është kërkuar që shoqëritë pjesëmarrës të kenë liçensë të kategorisë III.2.A dhe nuk kuptohet kërkesa për ing. Menaxhim Mjedisor.

e- **Në pikën 3.3.4 të DST** është kërkuar që OE të ketë drejtuesin teknik të përfshirë në liçensën e shoqërisë dhe me eksperiencë pune minimumi 10 vite dhe se do jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës.
Referuar VKM nr. 42, datë 16.01.2008, ku përcaktohet kriteret specifike që drejtuesi teknik duhet të plotësojë në mënyrë që shoqëria të përfitojë kategorinë që disponon në liçensën profesionale. Licenca që OE do paraqesë është dëshmia e mjaftueshme se është vlerësuar nga institucionet e autorizuara me ligj, dhe se disponon kapacitete dhe eksperienca dhe nuk është i nevojshëm kushti që drejtuesi teknik duhet të ketë eksperiencë pune 10 vjeçare.

Për aplikimin e kritereve jo të mirëargumetuara ngarkohet me përgjegjësi anëtarët e NHDT, *respektivisht*:

L K me profil Përgjegjëse e Zyrës Juridike.

Th F me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Transporteve dhe mirëmbajtjes së automjeteve

S Sh, me detyrë Specialist i Rinisë dhe Sporteve.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 3660, datë 28.12.2021 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

a- Bashkia Finiq, në përcaktimin e Kapacitetit ligjor / profesional, ka përcaktuar kriteret në lidhje me liçensa profesionale që operatoret ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojnë me kategoritë përkatëse sipas përcaktimeve në DST.

Në sistemin e prokurimeve elektronike nga autoriteti kontraktor krahas dokumenteve të tenderit janë publikuar projekti, specifikimet teknike si dhe preventivi me zërat e punëve që do të kryhen nga ku konstatohet se ka punime gërmim dheu, betonim, ndërtim depo, transport, mure, shtresa stabilizanti, çakulli, tuba HDPE, punime elektrike, makineri, etj.

Duke ju referuar lidhjes 4 të VKM-se Nr. 42, datë 16.01.2008, rezulton se bazuar në fondin limit të procedurës së prokurimit, kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.P. 1 – D "*Punime gërmimi në toke*" është plotësisht e ligjshme sepse kategoria e liçensë me germën "D" përfshijnë punime me vlere nga 101 – 200 milion leke. Disa prej zërave të punimeve të prokuruar nga autoriteti kontraktor konkretisht gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m^3, në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në mjet; gërmime dheu në seksion të lire me krahë, në toke të bute, Kateg.I-II, trans.k d deri 10 m, gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir, përfshihen në kategorinë e liçensë N.P. 1 D, si dhe punime komplekseve të lidhura me punimet në toke, me vlerë të preventivuar mbi 101 milion leke.

Kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.P. 5 – C Punime nëntokësore ura e vepra arti është plotësisht e ligjshme sepse kategoria e liçensë me germën "C" përfshijnë punime nga 51 – 100 milion leke. Disa prej zërave të punimeve të prokuruar nga autoriteti kontraktor përfshihen edhe në kategorinë e liçensë N.P. 5 C, kjo pasi ka të parashikuar realizimin e punimeve për ndërtimin e kalimeve dhe të veprave të artit, punime të lidhura në kompleksiteti me to që janë të nevojshme për të realizuar funksionimin e veprës, vlera e të cilave i tejkalon 51 milion lekë, referuar preventivit të punimeve.

Kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.P. 7 – F Ujësjellësi, gazsjellësi, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje, është plotësisht e ligjshme sepse kategoria e liçensë me germën "F" përfshijnë punime nga 401 – 800 milion leke. Duke marr për bazë faktin se kemi të bëjmë me prokurimin e një objekti që parashikon ndërtimin e një vepre hidrike, me

vlerë të fondit limit 469,080,695 Lekë pa t.v.sh. atëherë në përcaktimin e nivelit të kategorisë së licencës N.P. 7 është vendosur klasifikimi me germën "F" – punime nga 401 – 800 milion leke.

Kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.P. 9 – D Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime, është plotësisht e ligjshme sepse kategoria e liçensë me germën "D" përfshijnë punime nga 101 – 200 milion leke. Disa prej zërave të punimeve të prokuruar nga autoriteti kontraktor përfshihen edhe në kategorinë e liçensë N.P. 9 D kjo pasi ka të parashikuar realizimin e punimeve hidraulike, kalimeve dhe punimeve për trajtimin e ujerave sipërfaqësore, me vlerë të preventivuar jo më pak se 101 milion leke, e cila korrespondon me nivelin e klasifikimit "D".

Kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.P. 10 – B Ndertimi i impianteve per prodhimin e energjisë elektrike, është plotësisht e ligjshme sepse kategoria e liçensë me germën "B" përfshijnë punime nga 21 – 50 milion. Disa prej zërave të punimeve të prokuruar nga autoriteti kontraktor përfshihen edhe në kategorinë e liçensë N.P. 10 B kjo pasi ka të parashikuar realizimin e punimeve elektromekanike, elektrike dhe instalimin e pajisjeve me vlerë të preventivuar jo më pak se 21 milion, e cila korrespondon me nivelin e klasifikimit "B".

Kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.P. 11 – C Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformatorëve, etj., është plotësisht e ligjshme sepse kategoria e liçensë me germën "C" përfshijnë punime nga 51 – 100 milion leke. Disa prej zërave të punimeve të prokuruar nga autoriteti kontraktor përfshihen edhe në kategorinë e liçensë N.P. 11 C kjo pasi ka të parashikuar realizimin e punimeve elektromekanike, elektrike dhe instalimin e pajisjeve me vlerë të preventivuar jo më pak se 51 milion leke, e cila korrespondon me nivelin e klasifikimit "C".

Kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.S. 8 – D Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri, është plotësisht e ligjshme sepse kategoria e liçensë me germën "D" përfshijnë punime nga 101 – 200 milion leke. Disa prej zërave të punimeve të prokuruar nga autoriteti kontraktor përfshihen edhe në kategorinë e liçensë N.S. 8 D kjo pasi ka të parashikuar realizimin e punimeve për strukturat metalike dhe beton arme me vlerë të preventivuar jo më pak se 101 milion leke, e cila korrespondon me nivelin e klasifikimit "D".

Kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.S. 9 – D Punime strukturore speciale, është plotësisht e ligjshme sepse kategoria e liçensë me germën "D" përfshijnë punime nga 101 – 200 milion leke. Disa prej zërave të punimeve të prokuruar nga autoriteti kontraktor përfshihen edhe në kategorinë e liçensë N.S. 9 D kjo pasi ka të parashikuar realizimin e punimeve për strukturat speciale në shtratin e rrugës si dhe në ndërtimin e depove të ujit, me vlerë të preventivuar jo më pak se 101 milion leke, e cila korrespondon me nivelin e klasifikimit "D".

Kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.S. 10 – E Shtresa dhe mbistruktura speciale, është plotësisht e ligjshme sepse kategoria e liçensë me germën "D" përfshijnë punime nga 201 – 400 milion leke. Disa prej zërave të punimeve të prokuruar nga autoriteti kontraktor përfshihen edhe në kategorinë e liçensë N.S. 10 E kjo pasi ka të parashikuar realizimin e punimeve për shtresa, betonime dhe strukturat speciale me vlerë të preventivuar jo më pak se 201 milion leke, e cila korrespondon me nivelin e klasifikimit "E".

Kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.S. 16 – C Ndërtime të impianteve të ujit të pijshem dhe pastrimit të tij, është plotësisht e ligjshme sepse kategoria e liçensë me germën "C" përfshijnë punime nga 51 – 100 milion leke. Disa prej zërave të punimeve të prokuruar nga autoriteti kontraktor përfshihen edhe në kategorinë e liçensë N.S. 16 C kjo pasi ka të parashikuar realizimin e punimeve për furnizimin dhe cilësinë e ujit të pijshëm, me vlerë të preventivuar jo më pak se 51 milion leke, e cila korrespondon me nivelin e klasifikimit "C".

Kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.S. 20 – C Shpime gjeologjike - inxhinierike, puse e shpime për ujë, është plotësisht e ligjshme sepse kategoria e liçensë me germën "C" përfshijnë punime nga 51 – 100 milion leke. Disa prej zërave të punimeve të prokuruar nga autoriteti kontraktor përfshihen edhe në kategorinë e liçensë N.S. 20 C kjo pasi ka të parashikuar realizimin e punimeve në stacionin e pompimit dhe jo vetëm, me vlerë të preventivuar jo më pak se 51 milion leke, e cila korrespondon me nivelin e klasifikimit "C".

Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asetet të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Për sa i takon nivelit të klasifikimit të shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi kjo lidhet ngushtë me vlerën e llogaritur të objektit të kontratës si dhe zërave konkrete të punimeve që korrespondon me secilën kategori përkatëse.

Fakti që fondi limit i llogaritur për procedurën e mësipërme të prokurimit është 469,080,695 Lekë (pa t.v.sh.) tregon qartë se niveli i klasifikimit të përcaktuar është mëse i mjaftueshëm për përmbushjen e objektit të kontratës objekt prokurimi.

b- Në lidhje me kriterin për *mjek për periudhën Shkurt 2019 - Janar 2020, sqarojmë se nga AK* në DST ka kërkuar: Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij **1 (një) mjek** në bazë të paragrafit 12/2 të VKM nr. 692, datë 13.12.2001 "Për Masat e Veçanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM nr.108, datë 9.2.2011 "Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë" (i ndryshuar).

Çdo mjek për ushtrimin e këtij profesioni duhet që më parë të jetë i liçensuar nga urdhri i mjekëve, prandaj edhe është kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues të kenë të punësuar mjekun e shoqërisë të pajisur me Urdhër Mjeku.

c- Për të patur një rezultat sa me të mire në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve, duke ju referuar shtrirjes territoriale të linjave të shpërndarjes, depove të ujit, vendndodhjes gjeografike të tyre, si dhe nga eksperiencat e mëparshëm për kontrata të ngjashme, numri i stafit kryesor teknik, të përcaktuar nga specialistet e grupit të punës për hartimin e kritereve teknike/profesionale, është i lidhur ngushte me natyrën teknike të kontratës dhe i bazuar në ligj.

Numri i inxhiniereve përgjegjës kantieri, elektronik, drejtimi automatik, arkitekt, 2 inxhinier topograf dhe 2 inxhinier mjedisi lidhet ngushtësisht me natyrën e objektit të prokurimit dhe vendndodhjen e tij.

Nevoja për një inxhinier elektronik, drejtimi automatik është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtonit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afati, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objektit. Kjo pasi, në preventivin e prokuruar është parashikuar realizimi i punimeve të instalimeve që kërkojnë njohuri specifike dhe të specializuara, konkretisht, është parashikuar furnizimi dhe vendosja e pompave centrifugal dhe pajisje të tjera për realizimin e të cilave është e domosdoshme prania e inxhinierit elektronik, drejtimi automatik.

Kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e personelit të kualifikuar arkitekt është e domosdoshme, kjo referuar natyrës së punimeve të parashikuar për tu realizuar, sipas preventivit përmbledhës dhe nenobjekteve, është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar që operatoret ekonomike të disponojnë personel të kualifikuar Arkitekt Pejsazh, por është kërkuar disponimi i personelit drejtues teknik Arkitekt.

Kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e personelit të kualifikuar 2 inxhiniere mjedisi është e domosdoshme, kjo referuar natyrës së punimeve të mjedisit të parashikuar për tu realizuar, sipas preventivit përmbledhës dhe nenobjekteve, është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Shtrirja territorial, si dhe njohuritë specifike, referuar profilit për trajtimin e ujerave si dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis, janë dy profile të cilësuara të domosdoshme nga autoriteti kontraktor për mbarëvajtjen e punimeve.

Kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e personelit të kualifikuar 2 inxhiniere topograf (Markshajder) nuk nënkupton se domosdoshmërish kemi të bëjmë me kërkesën për disponimin e 2 inxhiniereve me profilin markshajder, por duke ditur që ndër vite stafi i formuar në gjeodezi, ka njohur ndryshime të emërtimeve të profileve, të tilla si gjeodezi apo markshajder, është vendosur ky kriter duke u mundësuar operatoreve ekonomik që për plotësimin e këtij kriteri do të pranohen inxhinieret që kanë mbaruar si topograf, profili gjeodezi apo edhe profili markshajder. Ky kriter ju vjen në ndihme operatoreve ekonomike. Kërkesa për staf inxhinierik prej 2 inxhinier topograf është e domosdoshme, kjo referuar natyrës së punimeve të parashikuar për tu realizuar, sipas preventivit përmbledhës dhe nenobjekteve, është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Shtrirja territorial, si dhe njohuritë specifike, e bëjnë të domosdoshme kërkesën për 2 inxhinier topograf.

d- AK për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të OE, të cilat vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet.

Duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen, sipas preventivit të punimeve të prokuruar, rezulton se janë parashikuar punime dhe veprimtari konkrete për zbatimin e të cilave është e domosdoshme asistenca teknike dhe profesionale me inxhiniere Menaxhimi Mjedisore dhe personel të certifikuar për auditim energjie. Konkretisht, terreni ku është parashikuar të realizohen punimet e preventivit të prokuruar nga autoriteti kontraktor janë të shtrira në një mjedis të hapur dhe të gjerë, i cili përfshin disa zona të ndryshme ku vlerësohet e domosdoshme prania e një personeli për auditimin dhe menaxhimin e mjedisit për të vlerësuar pasojat që shkaktohen në mjedis gjatë realizimit të punimeve të këtij objekti. Po ashtu, në preventivin e prokuruar nga autoriteti kontraktor, janë prokuruar punime "Rehabilitimi i Mjedisit", të cilat e bëjnë të domosdoshme praninë e stafit të kualifikuar për rehabilitimin e mjedisit. Gjithashtu, në preventivin e prokuruar janë parashikuar që do të realizohet furnizimi dhe vendosja e disa pajisjeve dhe pompave centrifugal, të cilat e bëjnë të domosdoshme asistencën e stafit të kualifikuar për auditimin e energjisë. Përveç sa më sipër, në preventivin e prokuruar nga autoriteti kontraktor, janë parashikuar të realizohen punime të instalimit të pajisjeve elektrike.

Në nenin 20 pika 4 të ligjit të posaçëm Nr. 10440 datë 7.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", i ndryshuar, citohet se, zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, i raporton ministrisë për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë". Gjithashtu po në këtë dispozite, parashikohet: "Projekt" është: a) zbatimi i punimeve të ndërtimit apo instalimeve ose skemave të tjera; b) ndërhyrje të tjera në mjedisin dhe peizazhin natyror, përfshire edhe ndërhyrjet që kanë të bëjnë me nxjerrjen e mineraleve, duke përfshirë njëherazi edhe projektin e procedurës së prokurimit".

Sa më sipër, është gjykuar se operatori ekonomik fitues i kontratës së prokurimit në cilësinë e zbatuesit të punimeve dhe në zbatim të parashikimeve që rrjedhin nga neni 20 pika 4 e ligjit specifik dhe aktit nënligjor në zbatim të ligjit, duhet të raportoje pranë autoritetit kontraktor në cilësinë e zhvilluesit të punimeve në kuptim të ligjit Nr. 10440 datë 7.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", i ndryshuar, për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë.

e- Përsa i përket kriterit të vendosur për përcaktimin e drejtuesit të projektit me një eksperiencë 10 vjeçare sqarojmë se ky kriter është vendosur në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin publik", i ndryshuar, në mbështetje të

germës “b”, të pikës 1, të nenit 46 si dhe VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 30, Seksioni II, Kreu III.
Është arsyetuar e nevojshme vendosja e këtij kriteri për drejtuesin e projektit, kjo për shkak edhe të natyrës së objektit, vështirësisë që paraqet terreni ku do të kryhen punimet, shtrirjes në sipërfaqen territorial dhe shtrirjes kohore për realizimin e këtij objekti.
Është vendosur ky kriter duke u bazuar në ligjin nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 i ndryshuar, pasi për çdo objekt zbatimi duhet të ketë drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij në përputhje me këtë ligj dhe vendimin Nr.312, datë 5.5.2010”Për miratimin e rregullores “për sigurinë në kantier”.

Qëndrim i grupit të KLSH-së:
Për sa argumentoni, sqarojmë se nga subjekti nuk është paraqitur asnjë argument shtesë nga ato të paraqitura në fazën e akt-konstatimeve, konkretisht:
a- Për sa argumentoni në lidhje me kategoritë e licensave, sqarojmë se nuk justifikojnë kërkesën për aplikimin e tyre, pasi siç jemi shprehur dhe në material disa nga këto kategori nuk kanë lidhje me zërat e projektit dhe se volumi që ato përfaqësojnë nuk përputhet me volumin e punimeve të çdo kategorie, kjo referuar zërave përkatës për të cilën dhe nga ana juaj nuk është bërë i detajuar.
Argumenti i paraqitur nga subjekti në lidhje me kriterin për mjek, nuk qëndron dhe i pabazuar në ligj, pretendime të cilat janë paraqitur nga grupi gjatë fazës së konstatimit.
b- Për sa argumentoni në lidhje me kriteret për inxhinierët, sqarojmë se pretendimet që paraqisni **nuk argumentojnë kriterin**, pasi siç jemi shprehur dhe në fazën e konstatimit disa nga inxhinierët nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit si inxhinieri i pasazheve, kemi një numër të konsiderueshëm inxhinierësh e cila nuk lidhet me shtrirjen e objektit. Argumentet që paraqisni nuk bazohen në nevojën e tyre, por referohen faktit nëse ndodheni para ngjarjeve të ndryshme. Ndërsa kriteret që aplikohen duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit dhe jo kritere që paraprijnë fakteve që mund ose nuk mund të ndodhin.
c- Për sa argumentoni në lidhje me kriterin për *1 (një Inxhinier Auditues të Energjisë (i pajisur me certifikate për auditimin e energjisë),* sqarojmë se argumentet nuk qëndrojnë, pasi aplikimi i tyre duhej të ishte gjatë fazës së hartimit të projektit dhe jo në zbatim. Të dy këto nuk kanë lidhje me tipologjinë e punimeve konkrete, veprime në kundërshtim me pikën 1 e nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.
Aplikimi i kësaj kërkesë është totalisht i paargumentuar dhe i fryrë, pasi po nga AK është kërkuar që shoqëritë pjesëmarrës të kenë liçensë të kategorisë III.2.A dhe nuk kuptohet kërkesa për ing. Menaxhim Mjedisor.
d- Argumentet që paraqisni në lidhje me drejtuesin teknik që të ketë një përvojë pune mbi 10 vite, nuk janë sqarues për grupin e KLSH, pasi nuk është theksuar se nuk duhet drejtuesi teknik ashtu siç shpreheni, por kemi theksuar se afati 10 vjeçar është i paargumentuar dhe se licenca që OE do paraqesë është dëshmia e mjaftueshme se është vlerësuar nga institucionet e autorizuara me ligj, dhe se disponon kapacitete dhe eksperienca.

- Zhvillimi i procedurës:
Me PV nr. 1226, datë 16.4.2020 është bërë hapja e procedurës dhe me PV nr. 1219, datë 17.4.2020 është bërë shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës.
Me nr. ---, datë 24.4.2020 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga Kryetari K K me vendim nr. 1275, datë 24.4.2020 mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 68 dhe 69, si më poshtë:

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë 4 ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

Nr.	OE pjesëmarrës	Nipti	Oferta	Kualifikuar/ Skualifikuar
1.	C	J....K	0	Skualifikuar
2.	Sh I F	J....T	466,528,839	Kualifikuar

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:
1. OE "C" nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, **pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për këtë proçedurë prokurimi.**

Nisur nga fakti që shoqëria "C" shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion, KVO pas skualifikimit të kësaj shoqërie dhe vlerësimit të dokumentacionit ka shpallur fitues Bashkimin e OE **"Sh I" & "F",** , me një vlerë të përgjithshme prej 466,528,839 lekë pa t.v.sh.
Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **17.04.2020**
Ankesa: **Jo**

Midis JV "Sh I F" sh.p.k dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 1306, datë 29.4.2020 për objektin "*Ujësjellësi Rajonale i Finiqit (linja e jashtme), Burimet e Merkos, ndërtim montime makineri e Paisje*" me vlerën 466,528,839 lekë me t.v.sh, me afat punimesh 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës, kjo datë do të konsiderohet si data e fillimit të punimeve.

-Vlerësimi i procedurës:
Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e subjekti dhe sistemin SEP të APP, u konstatua se KVO-ja **ka vlerësuar drejtë dokumentacionin** e paraqitur nga JV "ShIF" sh.p.k, pasi plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK dhe dispozitat ligjore të LPP.

2- Procedura e prokurimit me objekt *"**Rikonstruksion dhe zgjerim i linjës ekzistues të ujësjellësit Krongj - Finiq, linja të reja të jashtme të fshatrave Vrion, Karahaxh, Çlirim, Bregas si dhe linja e brendshme e fshatit Çlirim, Bashkia Finiq**",* me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës me objekt "*Rikonstruksion dhe zgjerim i linjës ekzistues të ujësjellësit Krongj - Finiq, linja të reja të jashtme të fshatrave Vrion, Karahaxh, Çlirim, Bregas si dhe linja e brendshme e fshatit Çlirim, Bashkia Finiq***"**.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 23, datë 7.12.2020 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Hapur**",	**3. Njësia e Prokurimit** K M K Th I M	**4. Komisioni VO** nr. 320, datë 7.12.2020 K Th A Çj M Ç
5. Fondi Limit (pa T.v.sh.) 250,906,055 lekë. REF-81407-12-08-2020	**6. Oferta fituese (pa T.v.sh.)** "SH I". me vlerën e ofertës 250,141,213 lekë pa T.v.sh..	**7. Diferenca me fondin limit (pa T.v.sh.) 765 mijë lekë pa T.v.sh. ose 0.30 %**
8. Data e hapjes së tenderit 8.01.2021	**9. Burimi Financimit** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.	**10. Operatorë Ekonomike pjesëmarrës 4 OE:** *Skualifikuar 3 OE* *Kualifikuar 1 OE*
11. Ankimime **AK**-ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK	**13. Përgjigje** KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 289, Datë 29.01.2021	**15. Vlera e kontratës (me T.v.sh.)** 250,141,213 lekë me afat 18 muaj.	

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditimi në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 8, datë 4.2.2020 është miratuar projekti me objekt " *Rikonstruksion dhe zgjerim i linjës ekzistues të ujësjellësit Krongj - Finiq, linja të reja të jashtme të fshatrave Vrion, Karahaxh, Çlirim, Bregas si dhe linja e brendshme e fshatit Çlirim, Bashkia Finiq*".
Me shkresën nr. 3069, datë 3.12.2020 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë *(Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve*)" është miratuar fondi në vlerën 250,906,055 lekë pa t.v.sh, i cili do financohet në 4 periudha ushtrimore, si vijon:
Për vitin 2021 shuma 50,181,210 lekë;
Në vitin 2022 në shumën 25,090,605 lekë;
Në vitin 2023 në shumën 25,090,605 lekë;
Në vitin 2024 në shumën 150,543,635 lekë.

Me shkresën nr. 3981, datë 4.12.2020, Bashkia Finiq i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve që mbi procedurë që Bashkia Finiq po zhvillon me objekt *"Rikonstruksion dhe zgjerim i linjës ekzistues të ujësjellësit Krongj - Finiq, linja të reja të jashtme të fshatrave Vrion, Karahaxh, Çlirim, Bregas si dhe linja e brendshme e fshatit Çlirim, Bashkia Finiq",* për mungesë stafi në këtë bashki, kërkohet të punësohet me kontratë 1 (një) ekspert i jashtëm si anëtarë i KVO, kjo në zbatim të nenit 58 të VKM nr. 614, datë 29.12.2014, me ndryshime.
Me shkresën nr. 3091/1, datë 7.12.2020 nga Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve është kthyer përgjigje Bashkisë Finiq, duke propozuar si pjesë të KVO ing. A Ç me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Projektimit dhe Oponencës në Drejtorinë e Planifikimit të Investimeve, për të cilën është lidhur kontrata e shërbimit nr. 3981/2, datë 4.12.2020.

Për objektin është lëshuar leje zhvillimore nr. 454, datë 16.2.2021 për JV "Sh I" + " F" me licensë nr. NZ 1495/22 & NZ 1163/18.

Me shkresën nr. 730/3, datë 20.4.2020 nga Instituti i Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është dërguar oponenca teknike për objektin *"Rikonstruksion dhe zgjerim i linjës ekzistues të ujësjellësit Krongj - Finiq, linja të reja të jashtme të fshatrave Vrion, Karahaxh, Çlirim, Bregas si dhe linja e brendshme e fshatit Çlirim, Bashkia Finiq"*.
Në përfundim është konkluduar se projekti i *"Rikonstruksion dhe zgjerim i linjës ekzistues të ujësjellësit Krongj - Finiq, linja të reja të jashtme të fshatrave Vrion, Karahaxh, Çlirim, Bregas si dhe linja e brendshme e fshatit Çlirim, Bashkia Finiq",* plotëson kushtet teknike të projektit, sipas konkluzioneve të dhëna për këtë oponencë teknike dhe të plotësuara para zbatimit të punimeve.

Projekt/preventivi është hartuar me procedurë prokurimi nga shoqëria "*H C*", miratuar me Vendim të AKUM nr. 35, datë 15.9.2020, ku si referencë e cimeve është bazuar në Vendimin e KM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të punimeve të ndërtimit dhe analiza teknike të tyre". Për zërat që nuk janë në manual është hartuar analiza teknike e çmimeve nga projektuesi.

- <u>Vlerësimi i kritereve</u>:
Në hartimin e DST në lidhje me kriteret rezulton se nuk ka gjetur zbatim Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26 "*Kontratat për punë publike*", pika 7 dhe neni 61, "*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*", pika 2, paragrafi 2, si dhe nuk kanë mbështetje ligjore kërkesat në lidhje me sa vijon:

f- **Nuk argumentohet kriteret e pikës 3.3.2**, për kategorinë e licensave NP-3/A-*Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e individuale, veshje fasada;* NP/10A-*Ndërtim impiantesh për prodhim energjie;* NP-12/B-*Punime inxhinierisë mjedisit;* NS-3/A-*Impiante ngritëse transportuese;* NS-4/B-*Punime rafinuar të nuraturës dhe të lidhura me to...;* NS-6/A-*Sinjalistika rrugore ndriçues;* NS-7/A-*Barriera dhe mbrojtje rrugore;* NS-10B-*Shtresa dhe mbi struktura special;* NS-19/A-*Sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë;* NS-20/A-*Shpik gjeologjik-inxhinierike, puse...;*. **këto kategori licencash nuk përcaktohen në zërat e preventivit.**

g- **Në pikën 3.3.3 të DST** është kërkuar staf teknik, si: **3 inxhinier ndërtimi**, ku njëri me profil transport dhe një me profil Gjeoteknik; **një ing. Elektronik**, drejtim automatik; **një ing. Gjeolog dhe një ing. Arkitekt**.
Referuar zërave të preventivit, AK nuk ka parashikuar asnjë veprimtari konkrete ku bëhet e nevojshme prezenca e inxhiniereve të mësipërm;
Gjithashtu kërkesa prej 17 inxhinierësh të kërkuar është i paargumentuar dhe i fryrë, veprime të cilat çojnë në mospjesëmarrjen e OE në garë. Për rrjedhojë kërkesa sa më lart nuk është e bazuar në përcaktimet e pikës 1, neni 26 të LPP.

h- **Në pikën 3.3.4 të DST** është kërkuar që OE të ketë drejtuesin teknik të përfshirë në liçensën e shoqërisë dhe me eksperiencë pune minimumi 10 vite dhe se do jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës.
Vendosja e afatit prej 10 viteve punë është i paargumentuar, pasi fakti që shoqëria paraqet liçensë është dëshmia e mjaftueshme për të treguar eksperiencën e tij.

Për aplikimin e kritereve jo të mirëargumetuara ngarkohet me përgjegjësi anëtarët e NHDT, *respektivisht*::

K M *me profil Juriste.*

I M me detyrë Specialist Drejtoria Juridike dhe Trajtimit ligjor të Pronave.

K Th, me detyrë Drejtor Kabineti.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 3660, datë 28.12.2021 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

a- Bashkia Finiq, në përcaktimin e Kapacitetit ligjor / profesional, ka përcaktuar kriteret në lidhje me liçensa profesionale që operatoret ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojnë me kategoritë përkatëse sipas përcaktimeve në DST.

Kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.P. 3 - A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e individuale, veshje fasada është plotësisht e ligjshme sepse kategoria e liçensë me germën "A" përfshijnë punime me vlere nga 0 – 20 milion leke. Disa prej zërave të punimeve të prokuruar nga autoriteti kontraktor konkretisht rikonstruksione, mirëmbajtje dhe veshje godine, përfshihen në kategorinë e liçensë N.P. 3 A, si dhe punime kompleksëve të lidhura me to, me vlerë të preventivuar 18,764,500 Leke.

Kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.P. 10 – A Ndertimi i impianteve per prodhimin e energjisë elektrike, është plotësisht e ligjshme sepse kategoria e liçensë me germën "A" përfshijnë punime nga 0 – 20 milion Leke. Disa prej zërave të punimeve të prokuruar nga autoriteti kontraktor përfshihen edhe në kategorinë e liçensë N.P. 10 A kjo pasi ka të parashikuar realizimin e punimeve elektrike dhe instalimin e pajisjeve me vlerë të preventivuar jo më pak se 7,850,420 Leke, e cila korrespondon me nivelin e klasifikimit "A".

Kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.P. 12 – B Punime të inxhinierisë së mjedisit, është plotësisht e ligjshme sepse kategoria e liçensë me germën "C" përfshijnë punime nga 21 – 50 milion leke. Disa prej zërave të punimeve të prokuruar nga autoriteti

kontraktor përfshihen edhe në kategorinë e licensë N.P. 12 B kjo pasi ka të parashikuar realizimin e punimeve me ndikim në mjedis me vlerë të preventivuar jo më pak se 48,740,250 Leke, e cila korrespondon me nivelin e klasifikimit "B".

Kategoria e punimeve NS-3A, autoriteti kontraktor Bashkia Finiq sqaron se në preventivin e punimeve të ngarkuar nga autoriteti kontraktor në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është përfshire kryerja e punimeve për shkallë metalike apo Konstruksione metalike per shkalle etj. Duke ju referuar lidhjes 4 të VKM-se Nr. 42, datë 16.01.2008, rezulton se bazuar në fondin limit të procedurës së prokurimit, prej 250,906,055 Lekë pa t.v.sh., kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.S. 3 – A Impiante ngritëse dhe transportuese është plotësisht e ligjshme.

Kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.S. 4 – B Punime rifiniture të muratures dhe të lidhura me to, rifiniture me infrastrukture druri, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese, është plotësisht e ligjshme sepse kategoria e licensë me germën "B" përfshijnë punime nga 21 – 50 milion Leke. Disa prej zërave të punimeve të prokuruar nga autoriteti kontraktor përfshihen edhe në kategorinë e licensë N.S. 4 B kjo pasi ka të parashikuar realizimin e punimeve për ndërtimin e depove dhe punime të tjera me vlerë të preventivuar jo më pak se 38,480,250 Leke, e cila korrespondon me nivelin e klasifikimit "B".

Kategoria e punimeve NS-6A, autoriteti kontraktor Bashkia Finiq sqaron se në preventivin e punimeve të ngarkuar nga autoriteti kontraktor në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është përfshire kryerja e punimeve për shtrimin e rrugëve për në depo me asfalt, duke e bërë të domosdoshme vendosjen e sinjalistikës rrugore jo ndriçuese gjatë realizimit të këtyre punimeve.

Kategoria e punimeve NS-7A, autoriteti kontraktor Bashkia Finiq sqaron se në preventivin e punimeve të ngarkuar nga autoriteti kontraktor në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është përfshire kryerja e punimeve për shtrimin e rrugëve për në depo me asfalt, duke e bërë të domosdoshme vendosjen e barrierave dhe mbrojtjeve rrugore gjatë realizimit të këtyre punimeve. Duke ju referuar lidhjes 4 të VKM-se Nr. 42, datë 16.01.2008, rezulton se bazuar në fondin limit të procedurës së prokurimit, prej 250,906,055 Lekë pa t.v.sh., kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.S. 7 – A Barriera dhe mbrojtje rrugore është plotësisht e ligjshme.

Kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.S. 10 – B Shtresa dhe mbistruktura speciale, është plotësisht e ligjshme sepse kategoria e licensë me germën "B" përfshijnë punime nga 21 – 50 milion. Disa prej zërave të punimeve të prokuruar nga autoriteti kontraktor përfshihen edhe në kategorinë e licensë N.S. 10 B, kjo pasi ka të parashikuar realizimin e punimeve për shtresa dhe strukturat speciale me vlerë të preventivuar jo më pak se 21 milion, e cila korrespondon me nivelin e klasifikimit "B".

Kategoria e punimeve NS-19A, autoriteti kontraktor Bashkia Finiq sqaron se në preventivin e punimeve të ngarkuar nga autoriteti kontraktor në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është përfshire kryerja e punimeve për shtresat rrugore përfshire barrierat beton arme. Duke ju referuar lidhjes 4 të VKM-se Nr. 42, datë 16.01.2008, rezulton se bazuar në fondin limit të procedurës së prokurimit, prej 250,906,055 Lekë pa t.v.sh., kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.S. 19 – A Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat është plotësisht e ligjshme.

Kategoria e punimeve NS-20A, autoriteti kontraktor Bashkia Finiq sqaron se në preventivin e punimeve të ngarkuar nga autoriteti kontraktor në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është përfshire kryerja e punimeve për shpimet për të vlerësuar gjeologjinë për ndërtimin e objektit inxhinierik. Duke ju referuar lidhjes 4 të VKM-se Nr. 42, datë 16.01.2008, rezulton se bazuar në fondin limit të procedurës së prokurimit, prej 250,906,055 Lekë pa t.v.sh., kërkesa për të disponuar kategoritë e Licencës N.S. 20 – A Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë është plotësisht e ligjshme.

Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asetet të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Fakti që fondi limit i llogaritur për procedurën e mësipërme të prokurimit është 250,906,055 Lekë (pa T.V.SH.) tregon qartë se niveli i klasifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është mëse i mjaftueshëm për përmbushjen e objektit të kontratës objekt prokurimi.

b- Autoriteti kontraktor gjykon se për të patur një rezultat sa me të mire në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve, duke ju referuar shtrirjes territoriale të linjave të shpërndarjes, depove të ujit, vendndodhjes gjeografike të tyre, si dhe nga eksperiencat e mëparshme të Autoritetit Kontraktor për kontrata të ngjashme, numri i stafit kryesor teknik, të përcaktuar nga specialistet e grupit të punës për hartimin e kritereve teknike/profesionale, është i lidhur ngushte me natyrën teknike të kontratës dhe i bazuar në ligj.

Numri i inxhinierеve përgjegjës kantieri, 3 inxhinier ndertimi, inxhinier mjedisi, elektronik drejtimi automatik, gjeolog dhe arkitekt lidhet ngushtësisht me natyrën e objektit të prokurimit dhe vendndodhjen e tij. Nevoja për një inxhinier elektronik, drejtimi automatik është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtonit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afati, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objektit. Kjo pasi, në preventivin e prokuruar është parashikuar realizimi i punimeve të instalimeve që kërkojnë njohuri specifike dhe të specializuara, konkretisht, është parashikuar furnizimi dhe vendosja e pajisje për realizimin e të cilave është e domosdoshme prania e inxhinierit elektronik, drejtimi automatik. Kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e personelit të kualifikuar arkitekt është e domosdoshme, kjo referuar natyrës së punimeve të parashikuar për tu realizuar, sipas preventivit përmbledhës dhe nenobjekteve, është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit.

Kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e personelit të kualifikuar inxhinier ndertimi profile transport dhe 1 inxhinier ndertimi profile Gjeoteknik është e domosdoshme, kjo referuar natyrës së punimeve strukturore të parashikuara për tu realizuar në shtresat rrugore si dhe të karakterit teknik të sistemimeve rrugore dhe të punimeve të shtresave nëntokësore etj. të parashikuar për tu realizuar, sipas preventivit përmbledhës dhe nenobjekteve, është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit.

Kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e personelit të kualifikuar inxhinier mjedisi është e domosdoshme, kjo referuar natyrës së punimeve të mjedisit të parashikuar për tu realizuar, sipas preventivit përmbledhës dhe nenobjekteve, është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit.

Kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e personelit të kualifikuar inxhinier gjeolog është e domosdoshme, kjo referuar natyrës së punimeve gjeologjike të shpimit etj. të parashikuar për tu realizuar, sipas preventivit përmbledhës dhe nenobjekteve, është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit.

Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit, sikundër është qenia e tyre në listëpagesat e shoqërisë *për* ***periudhën 12 mujore,*** është vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se këta punonjës **janë operativë** pranë ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyre autoriteti kontraktor krijon bindjen se operatorët ekonomike pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet në mbështetje të germës “b” të pikës 1, të nenit 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik”, i ndryshuar.

c- Përsa i përket kriterit të vendosur për përcaktimin e drejtuesit të projektit me një eksperiencë 10 vjeçare sqarojmë se ky kriter është vendosur në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin publik", i ndryshuar, në mbështetje të germës "b", të pikës 1, të nenit 46 si dhe VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 30, Seksioni II, Kreu III.
Është arsyetuar e nevojshme vendosja e këtij kriteri për drejtuesin e projektit, kjo për shkak edhe të natyrës së objektit, vështirësisë që paraqet terreni ku do të kryhen punimet, shtrirjes në sipërfaqen territorial dhe shtrirjes kohore për realizimin e këtij objekti.
Është vendosur ky kriter duke u bazuar në ligjin 8402 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" datë 10.09.1998 i ndryshuar, pasi për çdo objekt zbatimi duhet të ketë drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij në përputhje me këtë ligj dhe vendimin Nr.312, datë 5.5.2010"Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".....

Qëndrim i grupit të KLSH-së:
Për sa argumentoni, sqarojmë se nga subjekti nuk është paraqitur asnjë argument shtesë nga ato të paraqitura në fazën e akt-konstatimeve, duke sqaruar se:
a- Për sa argumentoni në lidhje me kategoritë e licensave, sqarojmë se nuk justifikojnë kërkesën për aplikimin e tyre, pasi siç jemi shprehur dhe në material disa nga këto kategori nuk kanë lidhje me zërat e projektit dhe se volumi që ato përfaqësojnë nuk përputhet me volumin e punimeve të çdo kategorie, kjo referuar zërave përkatës për të cilën dhe nga ana juaj nuk është bërë i detajuar.
b- Për sa argumentoni në lidhje me kriteret për inxhinierët, sqarojmë se pretendimet që paraqisni **nuk argumentojnë kriterin**, pasi siç jemi shprehur dhe në fazën e konstatimit disa nga inxhinierët nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit si inxhinieri Artitekt. Argumentet që paraqisni nuk bazohen në nevojën e tyre, por referohen faktit nëse ndodheni para ngjarjeve të ndryshme. Ndërsa kriteret që aplikohen duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit dhe jo kritere që paraprijnë fakteve që mund ose nuk mund të ndodhin.
c- Argumentet që paraqisni në lidhje me drejtuesin teknik që të ketë një përvojë pune mbi 10 vite, nuk janë sqarues për grupin e KLSH, pasi nuk është theksuar se nuk duhet drejtuesi teknik ashtu siç shpreheni, por kemi theksuar se afati 10 vjeçar është i paargumentuar dhe se licenca që OE do paraqesë është dëshmia e mjaftueshme se është vlerësuar nga institucionet e autorizuara me ligj, dhe se disponon kapacitete dhe eksperienca.

- Zhvillimi i procedurës:
Me PV nr. 54, datë 8.01.2021 është bërë hapja e procedurës dhe me PV nr. 98, datë 14.01.2021 është bërë shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës.
Me nr. *218*, datë 22.01.2021 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga Kryetari K K me vendim nr. 1, datë 22.01.2021 mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 68 dhe 69, si më poshtë:

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë 4 ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

Nr.	OE pjesëmarrës	Nipti	Oferta	Vlerësimi
1.	ED K	K...I	250,830,512	Skualifikuar
2.	Gj K	J...U	250,743,727	Skualifikuar
3.	O	K...O	250,790,129	Skualifikuar
4.	SH I + F	J....T	250,141,213	Kualifikuar

Pas vlerësimit të dokumentacionit teknik, KVO nga 4 OE pjesëmarrës ka skualifikuar 3 OE dhe ka kualifikuar 1 (një) OE, konkretisht: Bashkimin e OE "Sh I + F" sh.p.k me një vlerë të përgjithshme prej 250,141,213 leke pa t.v.sh, *trajtuar më hollësisht në faqen 31-77 të Raport Auditmit*.

Midis Bashkimit të OE "Sh I + F" sh.p.k dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 289, datë 29.01.2021 për "*Rikonstruksion dhe zgjerim i linjës ekzistues të ujësjellësit Krongj - Finiq, linja të reja të jashtme të fshatrave Vrion, Karahaxh, Çlirim, Bregas si dhe linja e brendshme e fshatit Çlirim, Bashkia Finiq*" me vlerën 250,141,213 lekë me t.v.sh me afat punimesh **18 muaj** nga data e lidhjes së kontratës, kjo datë do të konsiderohet si data e fillimit të punimeve.

Nga auditimi ka rezultuar se skualifikimi i 3 operatorëve ekonomik bërë nga KVO është i drejtë, po kështu dhe shpallja fitues e Bashkimit të OE "Sh I + F" sh.p.k**.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 3660, datë 28.12.2021 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në DST të procedurës së prokurimit me objekt "*Rikonstruksion dhe zgjerim i linjës ekzistues të ujësjellësit Krongj - Finiq, linja të reja të jashtme të fshatrave Vrion., Karahaxh, Çlirim, Bregas si dhe linja e brendshme e fshatit Çlirim, Bashkia Finiq*" është përcaktuar se:

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr. 10 dhe dokumentacioni si më poshtë:

a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore, çertifikata e pronësisë së mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit.

b) Për mjetet e siguruara me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore, çertifikata e pronësisë së mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontratën noteriale të qerase e lidhur për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

c) Për mjetet dhe pajisjet e tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes, origjinale ose fotokopje e noteruar.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Për sa më sipër deklarojmë se:

- Nuk është kërkuar nga autoriteti kontraktor që operatoret ekonomik të paraqesin një vetëdeklarim që makineritë nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera deri në përfundimin e kontratës.
- Makineritë dhe pajisjet e paraqitura në procedurën e prokurimit nga JV "Shansi Invest" sh.p.k. & "Fusha" sh.p.k. jane disa here më shume, duke i tejkaluar kërkesat për kualifikim të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Gjithashtu nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërmarrjes data 29.04.2020 për objektin "*Ujësjellësi Rajonal i Finiq (Linja e jashtme) Burimet e Merkos*", deri në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes datë 29.01.2021 për objektin "*Rikonstruksion dhe zgjerim i linjës ekzistues të ujësjellësit Krongj - Finiq, linja të reja të jashtme të fshatrave Vrion., Karahaxh, Çlirim, Bregas si dhe linja e brendshme e fshatit Çlirim, Bashkia*

Finiq", janë situacionuar dhe faturuar mbi 66.8% e punimeve të kontratës së pare si dhe jane realizuar por nuk jane faturuar dhe situacionuar 80% e punimeve të kontratës se pare. Në këto kushte shume prej mjeteve dhe pajisjeve janë të lira. Për objektin "Ujësjellësi Rajonal i Finiq (Linja e jashtme) Burimet e Merkos", deri me datë 30.11.2020 janë prerë faturat tatimore si më poshtë:

- Fatura me numër 12, me datë 21.07.2020, me numër serie 69871512, me vlerë të faturuar prej 75,649,128 Lekë me t.v.sh.
- Fatura me numër 14, me datë 28.08.2020, me numër serie 69871514, me vlerë të faturuar prej 48,064,920 Lekë me t.v.sh.
- Fatura me numër 16, me datë 28.10.2020, me numër serie 69871516, me vlerë të faturuar prej 109,952,462 Lekë me t.v.sh.
- Fatura me numër 17, me datë 30.11.2020, me numër serie 69871517, me vlerë të faturuar prej 78,042,554 Lekë me t.v.sh.

Shuma e faturuar per objektin "Ujësjellësi Rajonal i Finiq (Linja e jashtme) Burimet e Merkos" deri me date 30.11.2020 është 311,709,064 Lekë.

Territori ku realizohen 2 objektet, e mundëson që mjetet të lëvizen lehtësisht nga njeri kantier në tjetrin brenda një periudhe shume të shkurtër në baze të proceseve të punës që realizohen në secilin objekt, duke i shërbyer realizimit të dy objekteve, bashkëlidhur kopje të situacioneve të punimeve të realizuara deri në datën e zhvillimit te procedurës së prokurimit për ujësjellësin Krongj-Finiq.

<u>Qëndrim i grupit të KLSH-së</u>

Për sa argumentoni pretendimet qëndrojnë dhe merren në konsideratë nga grupi i KLSH**.**

3- Procedura e prokurimit me objekt *"**Ndërtimi i ujësjellësit rajonal të Finiq nga burimet e Leshnicës**",* me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës me objekt "*Ndërtimi i ujësjellësit rajonal të Finiq nga burimet e Leshnicës***".**		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 22, datë 26.11.2020 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Hapur**",	**3. Njësia e Prokurimit** K M K Th I M	**4. Komisioni VO** nr. 306, datë 26.11.2020 K Th A Ç A K
5. Fondi Limit (pa T.v.sh.) 393,824,007 lekë. REF-80731-12-02-2020	**6. Oferta fituese (pa T.v.sh.)** "S" sh.a. me vlerën e ofertës 385,447,005 lekë pa T.v.sh..	**7. Diferenca me fondin limit (pa T.v.sh.) 8,377 mijë lekë pa T.v.sh. ose 2.12 %**
8. Data e hapjes së tenderit 5.01.2021	**9. Burimi Financimit** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.	**10. Operatorë Ekonomike pjesëmarrës 4 OE:** *Skualifikuar 3 OE* *Kualifikuar 1 OE*
11. Ankimime **AK**-ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK	**13. Përgjigje** KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 290, Datë 29.01.2021	**15. Vlera e kontratës (me T.v.sh.)** 385,447,005 lekë me afat 18 muaj.	

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditimi në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me Vendim të KB nr. 8, datë 4.2.2020 është miratuar projekti me objekt " *Ndërtimi rajonal i Finiqit – Linjat e jashtme të burimeve të Merkos dhe Leshnicës*".

Me shkresën nr. 2959, datë 19.11.2020 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (*Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve*)", është miratuar fondi në vlerën 472,336,166 lekë me t.v.sh., i cili do financohet në 4 periudha ushtrimore, si vijon:

Për vitin 2021 shuma 78,722,694 lekë;

Në vitin 2022 në shumën 39,361,347 lekë;

Në vitin 2023 në shumën 39,361,347 lekë;
Në vitin 2024 në shumën 236,378,619 lekë.

Me shkresën nr. 3847, datë 23.11.2020, Bashkia Finiq i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve që mbi procedurë që Bashkia Finiq po zhvillon me objekt *"Ndërtimi i ujësjellësit rajonal të Finiq nga burimet e Leshnicës",* për mungesë stafi në këtë bashki, kërkohet të punësohet me kontratë 1 (një) ekspert i jashtëm si anëtarë i KVO, kjo në zbatim të nenit 58 të VKM nr. 614, datë 29.12.2014, me ndryshime.
Me shkresën nr. 3000/1, datë 24.11.2020 nga Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve është kthyer përgjigje Bashkisë Finiq, duke propozuar si pjesë të KVO ing. A Ç me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Projektimit dhe Oponencës në Drejtorinë e Planifikimit të Investimeve.

Me shkresën nr. 1422/2, datë 8.7.2020 nga Instituti i Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është dërguar oponenca teknike për objektin *"Ndërtimi i ujësjellësit rajonal të Finiq nga burimet e Leshnicës",* kjo sipas kërkesës së Bashkisë Finiq nr. 1422, datë 23.6.2020.
Në përfundim është konkluduar se projekti i *"Ndërtimi i ujësjellësit rajonal të Finiq nga burimet e Leshnicës",* plotëson kushtet teknike të projektit, sipas konkluzioneve të dhëna për këtë oponencë teknike dhe të plotësuara para zbatimit të punimeve.

Projekt/preventivi është hartuar me procedurë prokurimi nga shoqëria "*HC*", miratuar me Vendim të AKUM nr. 40, datë 20.1.2020, ku si referencë e cimeve është bazuar në Vendimin e KM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të punimeve të ndërtimit dhe analiza teknike të tyre". Për zërat që nuk janë në manual është hartuar analiza teknike e çmimeve nga projektuesi.
Me PV nr. 3908, datë 27.11.2020 nga NJHDT është hartuar fondi limit.

ANKESA
Nga shoqëria "*AM*" sh.p.k me datë 4.12.2020 *(prot bashkia Finiq nr. 4017, datë 7.12.2020)* është paraqitur ankesë në lidhje me disa prej kritereve të aplikuara në DST.
Me urdhër nr. 323, datë 11.12.2020, titullari i AK ka urdhëruar pezullimin e procedurës dhe ngritur KSHA me përbërje: *K Th, A K dhe A Ç për shqyrtim të ankesës.*
Me PV nr. 4065, datë 11.12.2020 është konkluduar se pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë për ndryshim, ku me vendim nr. 1, datë 11.12.2020 është vendosur mos pranimi i ankesës.
Me urdhër nr. 326, datë 14.12.2020 të titullarit të AK është urdhëruar mos pranimi i ankesës së shoqërisë " *AM*" sh.p.k.
Me shkresën nr. 4017, datë 14.12.2020 nga Bashkia Finiq i është kthyer përgjigje shoqërisë "*AM*" sh.p.k për mos marrje në konsideratë të ankesës.

- Vlerësimi i kritereve:
Në hartimin e DST në lidhje me kriteret rezulton se nuk ka gjetur zbatim Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26 "Kontratat për punë publike", pika 7 dhe neni 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, paragrafi 2, si dhe nuk kanë mbështetje ligjore kërkesat në lidhje me sa vijon:
Në pikën 2.3.2 të DST, është kërkuar që OE të paraqesin liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës**:**

- *NP-11/A (Ndërtime për Nënstacionet, Kabinat e Transformatorëve, linjat të TN e të mesëm dhe shpërndarjen e Energjisë).*

- *NS-13/A (Impiante dhe Linja telefonie e Telekomunikacioni)*

Referuar zërave të preventivit, konstatohet se nuk ka punime për argumentimin e këtyre licensave**.**

Në pikën 2.3.8 të DST është kërkuar që OE te këtë ne stafin e tij te punësuar të cilët të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Maj 2020 –Tetor 2020, 1 (një) Ekspert mjedisi te pajisur me Certifikate "Për Vlerësimin e ndikimit ne mjedis dhe auditim mjedisor".
Kërkesa për një ekspert mjedisi është i paargumentuar, pasi bazuar në preventivin e punimeve, rezulton se nuk ka asnjë lloj punimi për të cilën të duhej një ekspertizë e tillë. Për rrjedhojë kërkesa sa më lart nuk është e bazuar në përcaktimet e pikës 1, neni 26 të LPP.

Në pikën 2.3.13 të DST është kërkuar që për mjetet e pasjet teknike ndër të tjera të ketë *Autobot për pastrim kanali dhe Puseta(vëllimi i botit mbi 20,000 l), 1 (një) copë dhe Impiant per trajtimin e ujerave te ndotura, për 2 (dy) copë.*
Kërkesat e mësipërm nuk janë të argumentuara me objektin e prokurimit, pasi mjetet e kërkuara janë mjete që përdoren nga bashkitë për pastrim dhe nuk janë mjete që lind nevoja gjatë procesit të zbatimit të projektit.

Për mos mirëargumentim të kritereve ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NHDT, *respektivisht*:
K M *me profil Juriste.*

I M me detyrë Specialist Drejtoria Juridike dhe Trajtimit ligjor të Pronave

K Th, me detyrë Drejtor Kabineti.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 3660, datë 28.12.2021 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
a- Sqarojmë se liçensa **NP-11/A dhe SN-13/A –** janë kërkuar nga AK pasi ka gjykuar te nevojshme kërkimin e këtyre pikave si pasoje e natyrës dhe tipologjisë se punimeve per realizimin e rrjetit te ujësjellësit, shtrirja e te cilit zgjatet ne fshatrat përkatëse (Leshnice, Cerkovice, Shen Ndre, Dhiver, Llupcat), dhe si e tille mund te shkaktoje ndërhyrje te mundshme ne linjat ekzistuese te shpërndarjes se energjisë dhe linjat telefonike dhe te telekomunikacionit. Me qellim realizimin e kthimit ne gjendjen e mëparshme te zonave subjekt ndërhyrjeje, Autoriteti Kontraktor ka gjykuar te arsyeshme vendosjen e kategorisë me te ulet per këto punime (A), duke marre parasysh se natyra e këtyre punimeve është rehabilituese.
Ndërsa liçensa **NS – 9C -** AK ka gjykuar te nevojshme kërkimin e kësaj pike ne Liçensën e OE pasi referuar projektit dhe preventivit, janë parashikuar punime lidhur me ndërtimin e "*Kaptazheve", "Dhomave te klorinimit", "Puseta ajrimi dhe shkarkimi", "Rezervuare", "Depo grumbulluese", "Puse shuarje energjie".*
Ne mënyrë qe realizimi i këtyre veprave te kryhet konformë kërkesave teknike dhe te mund te garantoje funksionalitetin e sistemit, Autoriteti Kontraktor ka gjykuar te rëndësishëm përzgjedhjen e një Operatori Ekonomik me eksperiencën e nevojshme ne kryerjen e punimeve strukturore speciale.
b- Në lidhje me kërkesën për ekspert mjedisi, sqarojmë se *AK* ka gjykuar thelbësore pasjen e një ekspert mjedisi ne stafin i cili do te ishte përgjegjës per mbikëqyrjen dhe raportimin periodik te ndikimit ne mjedis gjate zhvillimit te punimeve. Per shkak te natyrës se shtrirjes se projektit dhe te kompleksiteti te tij, domosdoshmëria e një personi te kualifikuar per planifikimin dhe menaxhimin e ndikimit ne mjedis dhe marrjen e masave te posaçme mjedisore është e larte.

c- Në lidhje me konstatimin për kriterin *Licensën kodi III.2.B" Grumbullim dhe Transporti i Mbetjeve Urbane", Licensën kodi III.2.B" Për grumbullimin dhe Transportin e Mbetjeve Inerte dhe Dherave" dhe Licensën kodi III.2.B" Për grumbullimin dhe Transportin e Mbetjeve nga Ujërat e Ndotura",* sqarojmë se **Licensë III.2.B,** bazuar në preventivin e punimeve AK ka analizuar se ka zëra gërmimi në volume të mëdha, si dhe transportimi i tyre me auto deri në 5 km, si dhe nisur nga vetë objekti i prokurimit ku punimet kryesore janë punime të nevojshme për shtrimin e linjës së tubacioneve, të cilat gjate zbatimit te kontratës do te gjenerojnë mbetje (urbane, inerte , dhera si dhe ujëra të ndotura) të nevojshme për tu transportuar dhe larguar nga kantieri i ndërtimit.
Rrjedhimisht AK ka kërkuar OE të liçensuar për transportimin e mbetjeve te gjeneruara sipas akteve ligjore në fuqi. Për sa kohë në dokumentet standarte të tenderit, në preventivin e punimeve si dhe ne specifikimet teknike janë parashikuar punime të cilat gjenerojnë mbetjet urbane, mbetje të ujerave të ndotura si dhe mbetje inerte dhe dhera, kërkesat e mësipërme të hartuara nga Autoriteti Kontraktor janë në përputhje me vëllimin e projektit subjekt prokurimi.
d- Në lidhje me konstatimin se kërkesat për *Autobot për pastrim kanali dhe Puseta(vëllimi i botit mbi 20,000 l), 1 (një) copë dhe Impiant per trajtimin e ujerave te ndotura, për 2 (dy) copë, janë të paargumentuara, sqarojmë se "*Autobot per pastrim kanali dhe Puseta", **p**er shkak te tipologjisë se ndërhyrjes dhe shtrirjes se konsiderueshme te projektit, per raste avarie te ndryshme qe mund te ndodhin gjate ndërtimit te cilat do te ndikonin negativisht ne mbarëvajtjen e punimeve, AK ka gjykuar qe te jete ne dispozicion dhe një autobot per pastrim kanali dhe pesetash.
Ndërsa në lidhje me "**Impiant per trajtimin e ujerave te ndotura", n**isur nga mungesa e infrastrukturës ne fshatrat te cilat preken nga projekti si dhe nga mungesa e gropave septike (ujerat e ndotura shkarkohen ne luginat dhe përrenjtë), Autoriteti Kontraktor ka gjykuar te nevojshme disponimin e dy impianteve te trajtimit per ujerat e ndotura, njeri prej te cilëve do te jete ne funksion te trajtimit te ujerave ne ato zona ku shtrimi i linjave te tubacioneve mund te ndërpritet me linjat ekzistuese te KU Impianti i dyte i trajtimit te ujerave do te jete i stacionuar dhe ne funksion te trajtimit te ujerave te ndotura te gjeneruara nga stafi i OE gjate realizimit te punimeve.

Qëndrim i grupit të KLSH-së:
Për sa argumentoni, sqarojmë se nga subjekti nuk është paraqitur asnjë argument shtesë nga ato të paraqitura në fazën e akt-konstatimeve, duke argumentuar se:
a- Për sa pretendoni, argumentet nuk janë bindës për grupin e KLSH, pasi siç jemi shprehur dhe në material, referuar zërave të preventivit nuk ka punime që kërkojnë këto lloje kategori licencash dhe nuk mund të aplikohet kriter që nëse gjatë zbatimit të projektit do ketë dëmtime të rrjetit elektrik duhet të ketë këtë kategori licencash.
b- Për sa argumentoni në lidhje me kriterin që OE duhet të kenë ekspert mjedisore, sqarojmë se pretendimet nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë, pasi është i paargumentuar, bazuar në preventivin e punimeve dhe nuk ka asnjë lloj punimi për të cilën të duhej një ekspertizë e tillë.
c- Për sa argumentoni në lidhje me këtë kriter, sqarojmë se pretendimet nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë, pasi kërkesat e mësipërm nuk janë të argumentuara me objektin e prokurimit, pasi mjetet e kërkuara janë mjete që përdoren nga bashkitë për pastrim dhe nuk janë mjete që lind nevoja gjatë procesit të zbatimit të projektit. **Përfundimisht procedura mbetet me shkelje në aplikimin e kritereve.**

- Zhvillimi i procedurës:
Me PV nr. 3909/1, datë 5.01.2021 është bërë hapja e procedurës dhe me PV nr. 3909/2, datë 12.01.2021 është bërë shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës.

Me nr. *181*, datë 20.01.2021 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga Kryetari K K me vendim nr. 1, datë 20.01.2021 mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 68 dhe 69, si më poshtë:

Sipas këtij raporti, konstatohet se kanë qenë pjesëmarrës në procedurë 4 ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

Nr.	OE pjesëmarrës	Nipti	Oferta	Vlerësimi
1.	B	J....R	392,714,713	Skualifikuar
2.	C	J....K	0	Skualifikuar
3.	EDK	K...I	391,833,136	Skualifikuar
4.	S	J....G	385,447,005	Kualifikuar

Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se KVO nga 4 OE pjesëmarrës janë skualifikuar 3 OE dhe kualifikuar një, duke shpallur fitues shoqërinë „S" sh.p.k me një vlerë të përgjithshme prej 385,447,005 lekë pa t.v.sh., **është identifikuar si oferta e suksesshme**.
Vlerësimi i bërë nga KVO si për OE të skualifikuar dhe ai i shpallur fitues është në përputhje me dispozitat e LPP, *trajtuar më hollësisht në faqen 31-77 të Raport Auditmit.*

4- Procedura e prokurimit me objekt ***"Blerje materiale ndërtimi*** *",* me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës me objekt "*Blerje materiale ndërtimi* **""**.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 5, datë 23.03.2021 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Hapur**",	**3. Njësia e Prokurimit** E M V L S J	**4. Komisioni VO** nr. 70, datë 23.3.2021 KTh J H FTh
5. Fondi Limit (pa T.v.sh.) 9,491,753 lekë REF-92414-04-07-2021	**6. Oferta fituese (pa T.v.sh.)** "I" sh.a. me vlerën e ofertës 8,847,795 lekë pa T.v.sh..	**7. Diferenca me fondin limit (pa T.v.sh.) 644 mijë lekë pa T.v.sh. ose 6.7 %**
8. Data e hapjes së tenderit 30.4.2021 ndryshuar me datë 4.5.2021	**9. Burimi Financimit** Buxheti i bashkisë.	**10. Operatorë Ekonomike pjesëmarrës 4 OE:** *Skualifikuar 1 OE* *Kualifikuar 3 OE*
11. Ankimime **AK**-ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK	**13. Përgjigje** KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 2304, Datë 31.8.2021	**15. Vlera e kontratës (me T.v.sh.)** 8,847,795 lekë me afat 12 muaj.	

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditimi në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me PV nr. 792/1, datë 15.3.2021 nga njësia e prokurimit është hartuar fondi limit në vlerën 9,491,753 lekë, bazuar në çmimet e manualit të miratuar me Vendimin e KM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre".

- **<u>Vlerësimi i kritereve</u>**:

Nga auditimi i kritereve sipas DST, konstatohet se disa prej kritereve nuk janë në përputhje me tipologjinë e kontratës, si më poshtë vijon:

a- Është e paargumentuar kriteri për numër punonjësish prej 6 personash, pasi kemi të bëjmë me blerje malli, në kundërshtim me nenin 46/4 të LPP;
b- Është e paargumentuar kriteri për inxhinier ndërtimi, pasi nuk lidhet me tipologjinë e kontratës, pasi nga AK nuk është parashikuar asnjë shërbim apo veprim për të

argumentuar nevojën e inxhinierit, kjo dhe në referencë të Vendimit nr. 6, datë 20.6.2019 të APP të publikuara në faqen zyrtare të APP;

c- Kërkesa për 3 Automakinist është e panevojshme pasi sipas kërkesës për mjete nuk ka makineri por janë mjete;

d- Është e paargumentuar kriteri për licencë kategori III.1/B, në rastin kur kemi të bëjmë me kontratë furnizimi dhe nuk është e nevojshme, pasi ju drejtohet personave të tretë që nuk kanë lidhje me procedurën;

Për mos mirëargumentim të kritereve ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NHDT, *respektivisht*:

E M me detyrë Drejtor Drejtoria Juridike dhe Trajtimit Ligjor të Pronave.

V L me detyrë Drejtor Drejtoria e PZHT

S J me detyrë Përgjegjës Sektori i mirëmbajtjes së rrugëve rurale.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 3660, datë 28.12.2021 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

-Pretendim i subjektit:

- Numri i punonjësve përputhet me totalin e punonjësve që kërkohet për ecurinë e zbatimit të kontratës në përputhje me zërat e preventivit, konkretisht blerje beton i gatshëm C20/25, rërë makinerie, çakëll mbeturinë për mbushje, gurë kave etj, të cilat nuk magazinohen por sillen direkt në objekt. Për të realizuar këtë kontratë duhen ashtu sikurse kërkohet në DST 3 autobetonier (tre persona), dy mjete vetëshkarkuese (dy persona) dhe një që është drejtuesi teknik i shoqërisë me arsimin Inxhinier Ndërtimi, pra në total shkojnë 6 persona.
- Nisur nga fakti se peshën kryesore në preventiv e zë furnizimi me beton C20/25 dhe në specifikimet teknike kërkohet garantimi i cilësisë së betonit strukturor C20/25 të furnizuar,përfaqsuesi i autoritetit kontraktor duhet të mbajë lidhje me drejtuesin teknik të operatorit ekonomik të kontraktuar për marrjen e mostrave të betonit në objekt, për të parë në laborator përputhshmërinë e këtyre rezultateve me markën e betonit te kërkuar, gjë te cilën mund ta kryeje vetëm një person i arsimuar si inxhinier ndërtimi. Kjo procedure vlen edhe per cilësinë e hekurit te betonit, gurit kave etj.
- Nisur nga fakti se janë kërkuar në kriterin e makinerive 3 autobetonier, rrjedhimisht do të kërkohet që operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij tre persona të cilët në gjuhën inxhinierike në rastin konkret emërtohen Automakinist.
- Liçenca në kuptimin e këtij kriteri nuk i kërkohet operatoreve ekonomik të cilët nuk janë prodhues të këtyre materialeve ,por shoqërive prodhuese me të cilat këta operatorë ekonomikë kanë lidhur kontratë qiraje apo kontratë furnizimi.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Pretendimet e subjektit nuk kanë asgjë të re nga ato të paraqitura në fazën e akt-konstatimeve. **Procedura mbetet me shkelje në kritere.**

- Zhvillimi i procedurës:

Me PV nr. 1158, datë 4.5.2021 është bërë hapja e procedurës, ku është konstatuar se kanë marrë pjesë 4 OE, si vijon:

1. Shoqëria "D" sh.p.k me ofertë 9,491,750 leke pa t.v.sh.
2. Shoqëria "I" sh.p.k me ofertë 8,847,795 leke pa t.v.sh.
3. Shoqëria "J" sh.p.k me ofertë 9,058,860 leke pa t.v.sh.
4. Shoqëria "K" sh.p.k me ofertë 9,167,725 leke pa t.v.sh.

Me PV nr. 1291, datë 19.5.2021 është bërë vlerësimi i procedurës. Sipas këtij procesverbali janë skualifikuar 2 OE, duke kualifikuar 2 OE.

Sipas këtij PV plotësojnë kriteret kualifikues shoqëritë " K" me ofertë 9,167,725 lekë dhe shoqëria "D" me ofertë 9,491,750 lekë. Bazuar në ofertat e paraqitura KVO ka vlerësuar në vend të parë shoqëria "D" me ofertë 9,167,725 lekë, më te vogël se shoqërisë " K".

Ankesa: PO nga operatori ekonomik "I" sh.p.k

a- Ankesë pranë autoritetit kontraktor

Ka paraqitur ankesë për vlerësimin e ofertave pranë autoritetit kontraktor Bashkia Finiq shoqëria "I" me shkresën nr. 8 prot, datë 22.05.2021, protokolluar pranë Bashkisë Finiq me nr.1351 prot, datë 24.05.2021.
Me urdhër nr.103, datë 25.05.2021 të Kryetarit të Bashkisë Finiq K K është pezulluar procedura e prokurimit dhe është ngritur KSHA-ve. Është shqyrtuar ankesa e shoqërisë "I" nga ky komision në procesverbalin e datës 26.05.2021, i cili me vendimin e tij nr.1, date 26.05.2021 ka refuzuar si të pavlefshme ankesën.
Me shkresë nr.1396, datë 27.05.2021 i është kthyer përgjigje ankimuesit operatorit ekonomik "I" .

b- Ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik

Shoqëria "I" më datë 28.05.2021 ka ankimuar vendimin e KVO-së pranë Komisionit të Prokurimit Publik (KPP). KPP-ja me vendimin e saj nr.945/1, date 02.06.2021 ka pranuar për shqyrtim ankesën e operatorit ekonomik "I", ka urdhëruar pezullimin e procedurës së prokurimit dhe i ka kërkuar autoritetit kontraktor Bashkia Finiq dërgim të informacionit të hollësishëm brenda pesë ditëve nga marrja e këtij vendimi.
Autoriteti Kontraktor Bashkia Finiq në zbatim të vendimit nr. 945/1, date 02.06.2021 të KPP-së, me shkresë nr.1527/2, datë 11.06.2021 ka pezulluar procedurën e prokurimit dhe ka përcjellë pranë këtij të fundit gjithë dokumentacionin e kërkuar.

Me vendim nr. 332/2021, datë 02.07.2021, KPP-ja, ka vendosur pranimin e kërkesës së operatorit ekonomik "I", si dhe ka urdhëruar AK Bashkia Finiq të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik "I" dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik, si dhe të vërë në dijeni KPP-në për zbatimin e këtij vendimi.

Me urdhër nr. 133, datë 13.07.2021 të Kryetarit te Bashkisë Finiq K K është urdhëruar KVO për zbatimin e vendimit nr. 332/2021 të KPP-se.
KVO me datë 14.07.2021 në zbatim të vendimit nr. 332/2021 të KPP, si dhe Urdhrit nr. 133, datë 13.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë Finiq ka kryer rivlerësimin e ofertave duke kualifikuar përveç ofertës së operatorit ekonomik "I" edhe ofertën e operatorit ekonomik "J", pasi në gjykimin e saj edhe kjo oferte ishte skualifikuar për të njëjtën arsye ashtu sikurse ajo e operatorit ekonomik "I".

Me shkresë nr. 1847/1, datë 22.07.2021 është vënë në dijeni KPP-ja për zbatimin e vendimit të saj nr. 332/2021, datë 02.07.2021. KPP me vendim nr.332/3/2021, datë 26.07.2021 ka vendosur të mos heqë nga pezullimi procedurën e prokurimit "Procedure e hapur", me nr. REF -92414-04-07-2021, me objekt "Blerje materiale ndërtimi", me fond limit 9,491,753 lekë pa T.V.SH., zhvilluar më datë 04.05.2021 nga AK Bashkia Finiq.
KVO të rivlerësojë këtë procedurë prokurimi duke skualifikuar ofertën e operatorit ekonomik "J", sipas statusit që ka patur në datën 21.05.2021, si dhe duke lënë të kualifikuar ofertën e operatorit ekonomik "I", sipas pikës 3, të vendimit të KPP nr.332/2021 prot, datë 02.07.2021.

Me nr. 133/1, datë 13.07.2021 urdhër të Kryetarit te Bashkisë Finiq K K është urdhëruar KVO për zbatimin e vendimit nr. 332/3/2021, datë 26.07.2021. KVO më datë 04.08.2021 kreu rivlerësimin e ofertave sipas përcaktimeve të vendimit nr. .332/3/2021, datë 27.07.2021 të Komisionit të Prokurimit Publik duke skualifikuar ofertën e operatorit ekonomik "J K", sipas statusit që ka patur në datën 21.05.2021, si dhe duke lënë të kualifikuar ofertën e operatorit ekonomik "I", sipas pikës 3,të vendimit të KPP nr. 332/2021 prot, datë 02.07.2021. Me shkresë nr. .2073/1, datë 04.08.2021 Autoriteti Kontraktor Bashkia Finiq ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit nr.332/3/2021, datë 27.07.2021.

Komisioni i Prokurimit Publik me vendim nr. 332/5/2021, date 09.08.2021 ka vendosur heqjen nga pezullimi të procedurës së prokurimit "Procedure e hapur", me nr. REF - 92414-04-07-2021, me objekt "Blerje materiale ndërtimi", me fond limit 9,491,753 lekë pa t.v.sh, zhvilluar më datë 04.05.2021 nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Finiq.

Me nr. *2236/1*, datë 3.8.2021 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga Administratori K K me vendim nr. 1, datë 7.6.2021 mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 68 dhe 65.
Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE "I", me një vlerë të përgjithshme prej 8,847,795 leke pa t.v.sh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

5- Procedura e prokurimit me objekt ***"Restaurim i Urës - Kanali Filipeu me strukturë metalike B/A ",*** me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës me objekt "*Restaurim i Urës - Kanali Filipeu me strukturë metalike B/A* **""**.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 9, datë 12.5.2021 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Hapur**",	**3. Njësia e Prokurimit** E M V J A K	**4. Komisioni VO** nr. 88, datë 11.5.2021 K Th A M I K
5. Fondi Limit (pa T.v.sh.) 15,423,307 lekë REF-95309-05-12-2021	**6. Oferta fituese (pa T.v.sh.)** "J + Sh" sh.a. me vlerën e ofertës 15,313,774 lekë pa T.v.sh..	**7. Diferenca me fondin limit (pa T.v.sh.) 110 mijë lekë pa T.v.sh. ose 0.007 %**
8. Data e hapjes së tenderit 31.5.2021	**9. Burimi Financimit** Buxheti i shtetit.	**10. Operatorë Ekonomike pjesëmarrës 1 OE:** *Skualifikuar 0 OE* *Kualifikuar 1 OE*
11. Ankimime **AK**-ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK	**13. Përgjigje** KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 1741, Datë 29.6.2021	**15. Vlera e kontratës (me T.v.sh.)** 15,313,774lekë me afat 42 ditë.	

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditimi në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me shkresën nr. 5052, datë 16.3.2021 të Ministrisë së FE është bërë transferimi i fondeve për transfertës e pakushtëzuar për vitin 2021 në shumën 22,000,000 lekë me objekti "*Restaurim i Urës - Kanali Filipeu me strukturë metalike B/A*".

Me PV nr. 1231/1, datë 12.5.2021 nga NJHDT është hartuar fondi limit në zbatim të Vendimin e KM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të punimeve të ndërtimit he analiza teknike e tyre". Nga auditimi rezulton se çmimet janë sipas manualit të çmimeve, për vlerën 15,423,307 lekë pa t.v.sh., hartuar nga **ing. V L** me detyrë Drejtor i PZHT.

Ankesa:
Me shtojcën 21 (formular ankese), shoqëria "I' me datë 17.5.2021 (prot Bashkia Finiq nr. 1353, datë 24.5.2021), ka paraqitur ankesë mbi disa kritere të paargumentuara.
Me urdhër nr. 102, datë 25.5.2021 të titullarit të AK është bërë anulimi i procedurës dhe shqyrtimi i ankesës nga komision i përbërë nga: ***K Th, A M dhe I K.***

KSHA me PV nr. 1389, datë 26.5.2021, është argumentuar se ankesa nuk është marrë në shqyrtim, pasi nga subjekti nuk është bërë ankesë njëkohësisht edhe në KPP, si dhe nuk është paguar tarifa e ankesës, kjo në zbatim me Kreun XIV të nenin 111 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".
Me vendim nr. 1, datë 25.5.2021 (nr. Prot 1390), KSHA pas shqyrtimit të ankesës ka vendosur të refuzojë si të pavlefshme, pasi nuk është sipas përcaktimeve të Kreun XIV të nenin 111 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".
Me urdhër nr. 104, datë 27.5.2021, titullari i AK ka vendosur mos pranimin e ankesës, e cila nuk është sipas përcaktimeve ligjore të LPP nr. 162/2020 datë 23.12.2020 dhe ngarkon NJHDT për njoftimin e subjekti.
Me shkresën nr. 1394, datë 27.5.2021, AK i kthen përgjigje shoqërisë "I" se ankesa nuk është marrë në shqyrtim pasi nuk është sipas përcaktimeve të Kreun XIV të nenin 111 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" .

- Zhvillimi i procedurës:
Me nr. *1443/2,* datë 7.6.2021 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga Kryetari K K me vendim nr. 1, datë 7.6.2021 mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 68 dhe 69, si më poshtë:
Sipas këtij raporti, konstatohet se kanë qenë pjesëmarrës në procedurë vetëm BOE "J" & "SH" sh.p.k, me ofertë ekonomike 15,313,774 lekë pa t.v.sh, ku pas vlerësimit të dokumentacionit KVO e ka shpallur fitues me një vlerë të përgjithshme prej 15,313,774 Leke pa T.V.SH., është identifikuar si oferta e suksesshme.
Midis JV "J+ Sh" Sh.p.k dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 1741, datë 29.6.2021 për "*Restaurim i Urës - Kanali Filipeu me strukturë metalike B/A* " me vlerën 15,313,774 lekë pa T.v.sh.. me afat punimesh 42 ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës.

-Vlerësimi i procedurës:
Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e subjekti dhe sistemin SPE të APP, u konstatua se KVO nuk ka vlerësuar drejtë dokumentacionin e paraqitur nga JV "J K + Sh" Sh.p.k, pasi nuk plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

a- Shoqëria "J "' nuk plotëson kategorinë e **liçensë NS-9/A**, e cila sipas marrëveshjes së bashkëpunimit mbulon 69% të punimeve;
b- Shoqëria "J" nuk paraqet certifikatë **ISO DS CET/TR 15128:2005** *Realizimi i riparimeve kanalizuese per shkarkime dhe kullime te ujërave* dhe certifikate **ISO BS EN 13331-1: 2002** *Realizimi i punimeve per veshjet e kanaleve dhe skarpateve te ndryshme;*

Për vlerësimin e padrejtë të procedurës ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO, *respektivisht*:
K Th *me detyrë Drejtor Drejtoria e Shërbimeve Utilitare, Komunitare dhe Administrative.*
A M, *me detyrë Drejtor Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes-Kullimit, Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Mjedisit Pyjeve dhe Kullotave.*
I K, *me detyrë Zv/Kryetar Bashkie*.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 3660, datë 28.12.2021 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

-Pretendim i subjektit:

Ashtu sikurse përmendëm në sqarimet lidhur me Akt-Konstatimin nr.4, ritheksojmë se oferta është paraqitur si Bashkim Operatorësh Ekonomik dhe si e tillë në zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 14, si dhe të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 74,pika 3 (akte këto të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e zhvillimit të kësaj procedure prokurimi) duhet që kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Në gjykimin e KVO-së dokumentacioni i paraqitur nga secili prej anëtarëve të kësaj BO është në përputhje me përqindjen e përcaktuar në marrëveshjen e bashkëpunimit. Ajo që realisht zë peshën kryesore në këtë projekt nisur nga zërat dhe volumet e preventivit është kategoria e liçencës N.S - 8A "Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri" dhe jo NS-9A "Punime strukturorë speciale", pasi urë kanali është me konstruksion metalik çeliku e beton arme, këto zëra që i përgjigjen kësaj kategorie zënë 54% të vlerës së projektit, kategori të cilën e disponon shoqëria "J" shpk e cila sipas marrëveshjes së bashkëpunimit mbulon 69% të punimeve.

Sa i përket zërave të preventivit të cilat në kontratën e bashkëpunimit nr.601, datë 28.05.2021 të lidhur midis OE "J" shpk dhe OE "Sh" shpk do të realizohen nga OE "J", në gjykimin tonë i përgjigjen kategoritë e liçencave që ky OE disponon.

Për këto zëra punimesh duhet kategoria NS-1A "*Punime për prishjen e ndërtimeve*", të cilën OE e disponon.

Për këto zëra punimesh duhet kategoria NP-1A "Punime gërmimi në tokë" dhe kategoria N.S - 8A "*Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri*" të cilët OE i disponon.

Për këto zëra punimesh duhet kategoria N.S - 8A "Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri" të cilën OE e disponon.

Për këto zëra punimesh duhet kategoria N.S - 8A "Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri" të cilën OE e disponon.

Për këto zëra punimesh duhet kategoria NP-1A "Punime gërmimi në tokë" ,N.P - 9A "*Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime*", si dhe kategoria N.S - 8A "*Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri*" të cilët OE i disponon.

Qëndrimi i grupit të KLSH-së:

Për sa argumentoni, sqarojmë se nga subjekti nuk është paraqitur asnjë argument shtesë nga ato të paraqitura në fazën e akt-konstatimeve, duke argumentuar se për sa pretendoni në lidhje me konstatimet e KLSH për kualifikim të padrejtë të *JV ""J + Sh" sh.p.k,* sqarojmë argumentet e paraqitura nuk sqarojnë situatën, pasi sipas grupit të auditmit shoqëria "J" nuk e disponon fare kategorinë e linecës NS-9/A, për të cilën ka marrë përsipër kryerjen e këtyre punimeve dhe nuk ka lidhje me volumin e tyre. **Pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë.**

6- Procedura e prokurimit me objekt ***"Rikonstruksion i rrugës Dermish - Jerme",*** me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës me objekt "*Rikonstruksion i rrugës Dermish - Jerme***"**".		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 4, datë 2.3.2021	**3. Njësia e Prokurimit** E M	**4. Komisioni VO** nr. 4/1, datë 2.3.2021

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Hapur",	E P F Th	K Th V L AK
5. Fondi Limit (pa T.v.sh.) 79,916,666 lekë REF-92055-03-31-2021	**6. Oferta fituese (pa T.v.sh.)** "K ... A K" sh.a. me vlerën e ofertës 51,920,560 lekë pa T.v.sh..	**7. Diferenca me fondin limit (pa T.v.sh.) 27,996 mijë lekë pa T.v.sh. ose 35 %**
8. Data e hapjes së tenderit 10.5.2021	**9. Burimi Financimit** Bashkia Finiq/grande.	**10. Operatorë Ekonomike pjesëmarrës 7 OE:** *Skualifikuar 0 OE* *Kualifikuar 7 OE*
11. Ankimime **AK**-ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK	**13. Përgjigje** KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 1942, Datë 19.7.2021	**15. Vlera e kontratës (me T.v.sh.)** 51,920,560 lekë me afat 5 muaj.	

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditimi në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me shkresën nr. 23727, datë 21.12.2020 të Ministrisë së FE është bërë transferimi i fondeve për transfertës e pakushtëzuar për vitin 2021 në shumën 97,000,000 lekë me objekti "*Rikonstruksion i rrugës Dermish-Jerme*".

Me PV nr. 857, datë 29.3.2021 nga NJHDT është hartuar fondi limit në zbatim të Vendimin e KM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të punimeve të ndërtimit he analiza teknike e tyre". Nga auditimi rezulton se çmimet janë sipas manualit të çmimeve, për vlerën 79,916,666 lekë pa T.v.sh., hartuar nga ing. V L me detyrë Drejtor i PZHT.

-Vlerësimi i kritereve:

Nga auditimi konstatohet se disa nga kriteret nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, si dhe nuk janë marrë në konsideratë megjithë rekomandimet e APP, si më poshtë:

Në pikën 2.3.7 të DST, është kërkuar që OE të jenë të pajisur me leje mjedisore për grumbullim dhe transport të mbetjeve me Kodi III.2.B, leje mjedisore për vlerësimin e mjedisit të auditim mjedisor me Kod III.2.A dhe leje mjedisore për masat kundra zjarrit me Kod I.2.A.

Lejet e mësipërme nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, pasi nuk janë me tipologjinë e objektit të kontratës, veprime në shkelje të nenit 46 të LPP dhe nenit 26 të Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.

Ekspertiza është ezauruar në fazën e procesit të studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të projektit, specifikimeve teknike dhe në kundërshtim me përcaktimet e pikës "a" të nenit 1 të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin dhe ndikimin në mjedis", sipas se cilës qëllimi është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, duke parandaluar, minimizimin dhe kompensimin të dëmit në mjedis, kjo nga projektet e propozuara përpara miratimit të tyre. *Pra shërbimet e ekspertizës në fjalë janë realizuar në fazën e studimit dhe projektimit të objekteve.* Aplikimi i kritereve të tilla, çon në mos pjesëmarrjen e OE në garë.

Në DST në pikën pika 2.3.4. OE duhet të paraqes vërtetim nga Bashkia Finiq për detyrime të papaguara. Nga AK po në këtë pikë është kërkuar që OE të paraqesin vërtetim mbi pagesën e taksave vendore në vendet ku ushtron aktivitet dhe jo detyrimisht nga njësia ku ekzekutohet kontrata, pasi është element identifikues për OE pjesëmarrës.

Për mos mirëargumentim të kritereve ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NHDT, *respektivisht*::

E M me detyrë Drejtor Drejtoria Juridike dhe Trajtimit Ligjor të Pronave.

E P me detyrë specialist Drejtoria e PZHT

F Th me detyrë Përgjegjës Sektori i shërbimeve të ndriçimit publik, dekorit dhe mirëmbajtjes së objekteve dhe varrezave publike.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 3660, datë 28.12.2021 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

- Është kërkuar leje mjedisore për vlerësimin e mjedisit të auditim mjedisor me Kod III.2.A pasi në preventiv janë parashikuar që do të realizohen punime me ndikim në mjedis, konkretisht: *Shkulje rrënjë te bimëve te vogla; Prerje peme > Φ 10cm + transport mbeturinash dhe Evadim mbeturinash te ndryshme*

Gjithashtu do të shkaktohet dhe ndotje e mjedisit gjatë realizimit të shumë zërave të tjerë të parashikuara në preventive (si pluhura etj), gjë e cila duhet vlerësuar gjatë fazës së zbatimit pasi kjo rrugë është pranë qendrave të banuara dhe mund të sjelli ndotjen e ajrit në këto qendra.

- Për shkak të rrezikut të zjarreve në zonat pyjore ku është parashikuar të realizohen punimet e këtij objekti është kërkuar leje mjedisore për masat kundra zjarrit me Kod I.2.A.Vërtet që për këtë leje nuk ka zëra në preventiv, por është detyra e Autoritetit Kontraktor që të parashikojë dhe risqet që mund të vinë gjatë zbatimit të kontratës e konkretisht zjarret duke kërkuar që OE pjesëmarrës të kenë leje mjedisore për masat kundra zjarrit me Kod I.2.A., e për të cilën është detyrë e kontraktorit që të marrë masat e duhura dhe të ketë eksperiencën e duhur për eliminimin e pasojave që mund të vijnë nga ky risk.

- Njësia e prokurimit e ka vendosur këtë në zbatim te ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore, pasi kërkohet qe ofertuesit të kenë shlyer të gjitha detyrimet e taksave vendore në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet ekonomik sipas te dhënave të QKB-së. Nisur nga fakti se në të shkuarën shumë subjekte të cilat kanë kryer punime për llogari të Bashkisë Finiq nuk kanë paguar detyrimet që rrjedhin për taksat lokale, është parë i domosdoshëm vendosja e këtij kriteri.

Qëndrim i grupit të KLSH-së:

Për sa argumentoni, sqarojmë se nga subjekti nuk është paraqitur asnjë argument shtesë nga ato të paraqitura në fazën e akt-konstatimeve. **Përfundimisht procedura mbetet me probleme në kritere.**

- Zhvillimi i procedurës:

Me nr. *1738,* datë 29.6.2021 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga Kryetari K K me vendim nr. 1, datë 9.6.2021 mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 68 dhe 69, si më poshtë:

Sipas këtij raporti, konstatohet se kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

Nr.	OE Pjesëmarrës	NIPTI	Oferta	Vlerësimi

Nr.	OE Pjesëmarrës	NIPTI	Oferta	Vlerësimi
1	2-T	K.....M	70,696,392	Kualifikuar
2	B	K....A	55,724,760	Kualifikuar
3	G	J....3V	71,645,288	Kualifikuar
4	K + A		63,816,636	Kualifikuar
5	K+ A		51,920,560	Kualifikuar
6	Sh + J		57,997,181	Kualifikuar
7	S	K....J	66,666,666	Kualifikuar

Nga KVO të 7 OE janë kualifikuar për fazën e vlerësimit të ofertave, pasi kanë plotësuar kriteret teknike.
Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE "K" & "A" sh.p.k, me një vlerë të përgjithshme prej 51,920,560 leke pa t.v.sh., është identifikuar si oferta e suksesshme.

Sipas KVO për JV "K" & "A" me ofertë 51,920,560 leke pa T.V.SH., oferta e paraqitur është anomalisht e ulët. Për këtë KVO me shkresën nr. 1598 datë 15.8.2021, ka kërkuar argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.
BOE "K" & "A", me shkresën nr. 1598/1 datë 18.6.2021 ka paraqitur argumentimin e ofertës anomalisht të ulët sipas rërave të preventivit dhe çmimeve të manualit.
KVO, pas vlerësimit të shpjegimeve të BOE "K" & "A", arrin në konkluzionin se shpjegimet argumentojnë ofertën e paraqitur, reflektuar këto në PV nr. 1233/2, datë 8.6.2021.

Midis JV "K+ A" Sh.p.k dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 1942, datë 219.7.2021 për "*Rikonstruksion i rrugës Dermish - Jerme*" me vlerën 51,920,560 lekë me T.v.sh.. me afat punimesh 60 ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës, kjo datë do të konsiderohet si data e fillimit të punimeve.

-Vlerësimi i procedurës:
Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e subjekti dhe sistemin SPE të APP, u konstatua se KVO ka vlerësuar drejtë dokumentacionin e paraqitur nga JV "K + A" Sh.p.k, pasi plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIM

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të marrë nga Drejtoria e Financës Bashkia Finiq për vitin 2020, u konstatua se shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 647,838 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 642,886 mijë lekë ose në masën 99 %, *kjo sipas artikujve*: paga në masën 97%, sigurime në masën 97 %, shpenzime operative në masën 98 %, dhe investime në masën 100 %.
Sipas burimeve të financimit dhe alokimit të fondeve për vitin 2020, u konstatua se nga transferta e pakushtëzuar (grandi) treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 133,563 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 133,563 mijë lekë ose në masën 100 %.
Nga këto*:*
- Investime nga vlera 39,394 mijë lekë e planifikuar, janë realizuar në vlerën 39,394 mijë lekë ose në masën 100 %.

- Nga të ardhurat e trashëguara dhe të ardhurat e vitit, treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 64,478 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 64,478 mijë lekë ose në masën 100 %.
- Nga transferta e pakushtëzuar me fonde të deleguara, janë planifikuar për vlerën 449,797 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 444,845 mijë lekë ose në masën 99 %.

Nga analiza e të dhënave për pjesën e të ardhurave, u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit të planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit. Kështu të ardhurat veta të planifikuara për vlerën 93,730 mijë lekë janë realizuar në vlerën 64,478 mijë lekë me diferencë për vlerën 29,252 mijë lekë. Pra planifikimi i shpenzimeve buxhetore nuk është real dhe i mbështetur në burime të sakta financimi për të ardhurat e veta, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" nenet 42,43,47,50,52 dhe 65; Udhëzimit të MF nr. 2 datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit" i ndryshuar, pikat 253, 354; Udhëzimit të MF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 40 dhe 48, si dhe vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.1, faqe 18-27 të Raportit Përfundimtar të Auditmit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin e të Ardhurave, të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Menjëherë dhe vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në buxhetin e miratuar për vitin 2020, nuk janë programuar si zë më vete, likuidimi i të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguara nga viti paraardhës, ku sipas pasqyrave financiare për vitin 2019 janë në shumën 134,462,229 lekë ose 41 % e buxhetit fillestarë.

Në fund të vitit 2020, sipas pasqyrave financiare ato paraqiten në shumën 65,375,633 lekë, *nga të cilat:* deri me datë 30.9.2021 janë likuiduar gjithsej vlera 22,255,487 lekë, duke mbetur për likuidim vlera **42,120,146 lekë, kjo si rezultat i mos realizimi i të ardhurave**.

Nga auditimi i pagesave për shpenzime operative/ investime/ etj, të realizuara nga ana e Bashkisë Finiq, për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020, u konstatua se 122 fatura në vlerën 18,954,299 lekë nuk janë likuiduar brenda afatit **30 ditor** nga momenti i paraqitjes se tyre.

Gjithashtu u evidentuan dhe 17 raste ku faturat e paraqitura për likuidim nuk janë likuiduar në vlerën e plotë të tyre, ku nga vlera e faturave prej 43,902 mijë lekë është likuiduar vlera prej 15,967 mijë lekë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, Udhëzimin e MF nr. 2 datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit" (me ndryshime), pikat 101, 253, 354; Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 40, 48 *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.1, faqe 18-27 të Raportit Përfundimtar të Auditmit).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq, të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material analizë për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, për vlerën **42,120,146 lekë** dhe të hartojë një grafik likuidimesh, duke zbatuar radhën e pagesave.

Në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkisë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020, nuk është kryer inventari fizik i Aktiveve Afatgjata.

Nga të dhënat e pasqyrave financiare (aktivi), u konstatua se në kontabilitet llogaritë 210 "*Toka, troje, terrene*", 211 "*Pyje Plantacione*", 212 "*Ndërtesa e Konstruksione*", 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*", 214 "*Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune*" 215 "*Mjete transporti*", nuk janë të analizuara, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave, si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj. Në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet.

Bazuar në sa më sipër nuk japin arsye që të kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive, për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" (me ndryshime) pikat 26, 28, 30, Kreu IV, pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu II, "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 5 *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2, faqe 27-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Auditmit).*

3.1 <u>Rekomandimi</u>: Kryetari i Bashkisë Finiq, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për inventarizimin e aktiveve të veta si: llogaritë 210 "*Toka, troje, terrene*", 211 "*Pyje Plantacione*", 212 "*Ndërtesa e Konstruksione*", 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*", 215 "*Mjete transporti*", duke bërë dhe verifikimin në terren të këtyre Aseteve.

Për diferencat eventuale të konstatuara dhe për vlerat jashtë përdorimit nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemimin e llogarive kontabël.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020 gjendja e llogarisë 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*" në aktiv nuk rakordon me gjendjen e llogarisë kundërparti 467 "*Kreditorë të ndryshëm*" dhe llogarisë 401-408 "*Furnitor e llogari të lidhura me to*" në pasiv të bilancit e cila paraqitet për vlerën 65,375,633 lekë, për faktin se diferenca për vlerën 15,270,092 lekë është pasqyruar në aktiv në llogarinë 4342 "*Operacione me shtetin (të drejta)*", veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 5 *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2, faqe 27-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. <u>Rekomandimi</u>: Drejtoria e Financës në Bashkinë Finiq, të marrë masa për sistemimet e llogarive me vlerat e tyre reale, për llogarinë 4342 "*Operacione me shtetin (Të drejta)*", për vlerën 10,083,148 lekë dhe llogarisë 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*", për vlerën 65,375,633 lekë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se llogaria 231 "*Shpenzime në proces për rritjen e AQT"* në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 0 (zero) lekë, por duhet pasqyruar për vlerën 215,996,403 lekë, pasi në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se për vitin 2020 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe

likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit të cilat janë pasqyruar në llogaritë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" për objektin " *Ujësjellësi rajonal Bashkisë Finiq linja e jashtme burimet e Merkos*" në vlerën 211,624,933 lekë dhe llogarinë 212 "*Ndërtime konstruksione*" për objektin "*Rikonstruksion i vatrës së kulturës Dhrovjan*" në vlerën 4,371,470 lekë, pra vlera e llogarie 231 "*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*", veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Aneksi 1, Klasa 23 *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2, faqe 27-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Finiq, të marrë masa për sistemimet e llogarive me vlerat e tyre reale duke kredituar llogarinë 231"*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*", në vlerën 215,624,933 lekë dhe debituar llogarinë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" në vlerën 211,624,933 lekë si dhe llogarinë 214 "*Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune*", për vlerën 4,371,470 lekë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021

6. Gjetje nga auditimi: Në fund të vitit 2020, llogaria 466 "*Kreditorë për mjetet në ruajtje*" në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 30,809,350 lekë, e rakorduar me Degën e Thesarit. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se kjo vlerë përfaqëson fondet e ngurtësuara, ku vlera 20,477,231 lekë i përket ngurtësimeve të viteve 2019 e më parë, të cilave u ka kaluar afati i garancisë.

Bashkia Finiq nga ana e saj nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për ç'bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për interes publik, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" (me ndryshime), Kap. II, pika 10 *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2, faqe 27-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Finiq, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2019 e më parë (vlera 20,477,231 lekë), për të cilat ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Delvinë, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Finiq ka transferuar në vitin 2020 asetet për shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime" sha në shumën 143,696,762 lekë që i përkasin llogarisë 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*".

Nga vlera 334,796,075 lekë e rivlerësuar nga ekspert vlerësues të pasurisë së paluajtshme të liçensuar me Vendim Gjykate nr. 23-2017-631(318), datë 04.04.2017, transferime të cilat nuk janë bërë me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe nuk janë bërë veprimet kontabël, për rrjedhojë pasqyrat financiare të vitit 2020, nuk pasqyrojnë saktë gjendjen e Aseteve të Bashkisë Finiq si aksionere në shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime" sh.a, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pikat 35/a, b, 42, 44 dhe Udhëzimin e MF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes se përgjithshme" Kap. II, neni 17 *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2, faqe 27-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për saktësimin e Aseteve që i përkasin shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime" sh.a.

Të bëhet transferimi i tyre me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët dhe të kryhen veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021

.

8. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e Drejtorisë së Financës, u konstatua se për periudhën 01.01.2020 deri më 30.6.2021 nga vlera e kontratave të lidhura prej 1,195,394 mijë lekë janë planifikuar dhe miratuar në buxhet për likuidim vlera 392,519 mijë lekë. Janë likuiduar deri me datë 30.6.2021 vlera prej 291,568 mijë lekë dhe mbetur për likuidim vlera **100,951 mijë lekë.**

Nga sa mësipërm, Bashkia Finiq planifikon procedura në mungesë të realizmit të të ardhurave, pasi megjithëse ka kontrata të pa likuiduara nga periudha në periudhë, vijon me planifikimin e procedurave të reja, pa një studim të mirëfilltë të fondeve në përdorim, **veprime të cilat në fund çojnë në rritjen e borxhit për faturat e palikuiduara.** Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91; Ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 40, 48: Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.3 faqe 35-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Finiq në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike gjatë hartimit të buxheteve, planifikimi i procedurave të prokurimit të jetë në raport me nivelin e të ardhurave të realizuara për vitin dhe grandeve të planifikuara nga buxheti qendror dhe jo me të ardhurat e parashikuara për vitin ushtrimorë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Referuar të dhënave të regjistrit të procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2020 deri më 30.6.2021, janë realizuar gjithsej **23** procedura me fond limit 1,317,897 mijë lekë dhe vlerë kontrate 1,246,303 mijë lekë, me ulje për vlerën 71,594 mijë lekë ose 5.4%.

Grupi i KLSH-së, referuar vlerësimit të të dhënave të materialitetit nga 23 procedura, me fond limit 1,317,897 mijë lekë, ka vlerësuar për auditim **8** procedura me fond limit 1,285,942 mijë lekë ose 97.5% të fondit të prokuruar.

Nga auditimi i **8** procedurave me fond limit 1,285,942 mijë lekë, janë konstatuara në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej **7** procedura me vlerë të fondit limit 266,329 mijë lekë ose 20.7% *(të dhëna të paraqitura në Aneks 2.4 të Raportit Përfundimtar të Auditmit)*, shkelje të cilat kanë konsistuar në këto mangësi:

I- Në **6 (gjashtë)** procedura, Njësia e Prokurimit Bashkia Finiq, ka aplikuar në dokumentet standarde të tenderit (DST), kritere jo me llojin e procedurave të zhvilluara dhe jo në përputhje me kuadrin ligjor të LPP, *konkretisht:*

- Procedura e prokurimit me objekt: *"Ujësjellësi Rajonale i Finiqit (linja e jashtme), Burimet e Merkos, ndërtim montime makineri e Paisje",* me Urdhër Prokurimi (UP) nr. 5, datë 05.03.2020, lloji i procedurës ˝"*Hapur*" dhe fond limit 469,080 mijë lekë, .
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Rikonstruksion dhe zgjerim i linjës ekzistues të ujësjellësit Krongj - Finiq, linja të reja të jashtme të fshatrave Vrion, Karahaxh, Çlirim, Bregas si dhe linja e brendshme e fshatit Çlirim, Bashkia Finiq",* me UP nr. 23, datë 7.12.2021, lloji i procedurës ˝"*Hapur*" dhe fond limit 250,906 mijë lekë .
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Ndërtimi i ujësjellësit rajonal të Finiq nga burimet e Leshnicës",* me UP nr. 22, datë 26.11.2020, lloji procedurës ˝"*Hapur*" dhe fond limit 393,824 mijë lekë .

- Procedura e prokurimit me objekt: *"Blerje materiale ndërtimi",* me UP nr. 5, datë 23.3.2021 dhe fond limit 9,491 mijë lekë, lloji procedurës ´"*Hapur*".
- Procedura e prokurimit me objekt: *"Rikonstruksion i rrugës Dermish - Jerme",* me UP nr. 4, datë 2.3.2021 dhe fond limit 79,916 mijë lekë, lloji procedurës ´"*Hapur*".

Veprime dhe mosveprime që bien në ndesh me Vendimin e KM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (me ndryshime), neni 26 "*Kontratat për punë publike*", pika 7 dhe neni 61, "*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*", pika 2, paragrafi 2 *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.3, faqe 35-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. <u>Rekomandimi</u>: Kryetari i Bashkisë Finiq në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikat e zhvillimit të procedurave me një OE.

Të bëhet argumentimi teknik për secilin kriter, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve dhe dokumentacioni i argumentimit të kritereve të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

II- Në procedurën me objekt: *"Restaurim i Urës - Kanali Filipeu me strukturë metalike B/A",* me fond limit 15,423 mijë lekë, procedurë në të cilën ka marrë pjesë 1 (një) operatorë ekonomik, respektivisht Bashkimi i OE "J" shpk & "Sh" shpk, me ofertë 15,313,774 lekë, operatori ekonomik i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve të DST të miratuara nga AK, procedura e cila duhej anuluar nga KVO-ja dhe zhvilluar procedurë tjetër me kushte më të favorshme për të siguruar përdorimin me efektivitet, efiçencë dhe ekonomicitet (3-E) të fondeve të prokuruar.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", (me ndryshime), neni 2, *"Parimet e përzgjedhjes",* neni 24, *"Anulimi i një procedure",* neni 46, *"Kualifikimi i ofertuesve",* pika 1, neni 47, "*S`kualifikimi i ofertuesve*", neni 53, *"Shqyrtimi i ofertave",* neni 55, *"Kriteret e përcaktimit të ofertës",* neni 58, *"Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës"*, Vendimi i KM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", (me ndryshime), neni 26, "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 5, neni 66, "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", neni 67, *"Klasifikimi i ofertave"*, neni 69, *"Njoftimi i fituesit"*, neni 70 *"Lidhja e kontratës"*, neni 78 **"***Ankesat në autoritetin kontraktor,* si dhe rekomandimeve të APP *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.3, faqe 35-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. <u>Rekomandimi:</u> Kryetari i Bashkisë Finiq, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kritereve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik pa ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet (3-E).

Menjëherë dhe në vijimësi

C. <u>MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR</u>

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Bashkia Finiq, konstatohet se në fund të vitit

2020 janë gjithsej debitorë **224** subjekte fizik/juridik në vlerën **15,332,000 lekë** dhe **5306** abonent familjarë në vlerë **157,346,000 lekë.**
Nuk u konstatua asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimit të debitorëve, deri në **nxjerrjen e urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal** të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve, veprime në kundërshtim me Kreun XI "*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" (me ndryshime) *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.1, faqe 26.28 të Raportit Përfundimtar të Auditmit).*
1.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike në Bashkinë Finiq, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2020 në vlerën **172,678,000 lekë**, *si më poshtë vijon***:**
a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare,.
b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),.
c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.
d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

D/I. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Shërbimin Civil:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", germat (b, c, ç) e nenin 58-"*Llojet e masave disiplinore*", të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Finiq** që t'i kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH–së, për periudhën 01.01.2020 deri më 30.6.2021, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për **1 (një) punonjës**, si më poshtë:
a) *Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, sipas shkronjës (c) të nenit 58*.

1- ***L M,*** *me detyrë Drejtor Finance për periudhën e auditimit.*

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në lidhje me vlerësimin e raporti financiarë të vitit 2020, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*"; Vendimin e KM nr. 248, datë 10.04.1998 "*Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre*" (me ndryshime) me Vendimin e KM nr. 25, datë 20.01.2001; Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*"; Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 9.3.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2 faqe 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Në lidhje me mos likuidimin e faturave sipas radhës së pagesave dhe krijimin e detyrimeve të faturave të palikuiduara në fund të periudhave ushtrimore, duke rritur vështirësinë financiare të Bashkisë Finiq, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, Udhëzimin e MF nr. 2 datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit" (me ndryshime), pikat 253 dhe 354, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 40, 48 dhe Udhëzimin e MF nr. 2, datë 6.2.2012 "Për procedurat Standard të zbatimit të buxhetit" neni 101 *(Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.1.2 faqe 21-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

E. MASA ADMINISTRATIVE:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar Raportit Përfundimtar të Auditimit (kapitulli III/2.3 faqen 35-67), mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2012, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; nenin 132 të ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe shkronjat (b, c, ç) e nenin 58-"*Llojet e masave disiplinore*" të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil"; nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" (me ndryshime) dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Finiq**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave **administrative ose masë disiplinore** në raport me shkeljet e konstatuara, për **12 (dymbëdhjetë) punonjësve,** si më poshtë:

1. **S Sh,** me detyrë Specialist i Rinisë dhe Sporteve.
2. **I M,** me detyrë Specialist Drejtoria Juridike dhe Trajtimit ligjor të Pronave.
3. **E M,** me detyrë Drejtor Drejtoria Juridike dhe Trajtimit Ligjor të Pronave.
4. **V L,** me detyrë Drejtor Drejtoria e PZHT.
5. **E P,** me detyrë specialist Drejtoria e PZHT.
6. **FTh,** me detyrë Përgjegjës Sektori i shërbimeve të ndriçimit publik, dekorit dhe mirëmbajtjes së objekteve dhe varrezave publike.
7. **ThF,** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Transporteve dhe mirëmbajtjes së automjeteve.
8. **K Th,** me detyrë Drejtor Kabineti.
9. **S J,** me detyrë Përgjegjës Sektori i mirëmbajtjes së rrugëve rurale.

Për shkeljet e mëposhtme:
Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 "*Kualifikimi ofertuesve*" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*" (me ndryshime); neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" (me

ndryshime), neni 26 "*Kontrata për punë publike*", pika (5); neni 61 "*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*", pika (2), paragrafi (2).

Brenda datës 30.3.2022

10. K Th, me detyrë Drejtor Drejtoria e Shërbimeve Utilitare, Komunitare dhe Administrative.
11. A M, me detyrë Drejtor Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes-Kullimit, Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Mjedisit Pyjeve dhe Kullotave.
12. I K, me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë Finiq

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me neni (24) "*Anulimi një procedure prokurimi*", pika (1), germa (ç); neni (46) "*Kualifikimi i ofertuesve*", pika (1); neni (53) "*Shqyrtimi ofertave*", pika (3) dhe (5), germa (a); (c); neni (55) "*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*", pika (1), germa (a), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*" (me ndryshime) dhe neni (66) "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika (3); neni (67) "*Klasifikimi ofertave*; neni (68) "*Raporti përmbledhës*"; Kreu (VIII) "*Kushte të përgjithshme për zbatim*"; neni (73) "*Mungesa e konkurrencës*", pika (1) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", (me ndryshime).

Brenda datës 30.3.2022

F. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRTËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit) , pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë**:

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.
2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

G. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për **2 (dy) ish- punonjësit** e mëposhtëm, ndajë të cilëve nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre, *konkretisht:*

1. L K me detyrë Përgjegjëse e Zyrës Juridike.

2. K Mi me profil Juriste.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT